



RAPORT

VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE TË
“POLIS-VALAMARË-RUNGAJE-MORAVË-GRAMOZ CCA”
ME FOKUS ZHVILLIMIN RURAL, MJEDISIN, PLANIFIKIMIN E
TERRITORIT, DUKE PËRFSHIRË NBS SI NJË PËRGJIGJE NDAJ
NDRYSHIMEVE KLIMATIKE.

PËRGATITUR NGA: MIHALLAQ QIRJO

“KY RAPORT ËSHTË HARTUAR NË KUADËR TË PROJEKTIT “**IMPROVE SUSTAINABILITY OF SOUTH-EASTERN CCAS IN ALBANIA- ISCCA**” ZBATUAR NGA ECOALBANIA DHE ME FINANCIM TË PONT. MBËSHTETJA E PONT-IT PËR PËRGATITJEN E KËTJË BOTIMI NUK PËRBËN NJË MIRATIM TË PËRMBAJTJES QË PASQYRON VETËM PIKËPAMJET E AUTORËVE DHE PONT NUK MUND TË JETË PËRGJEGJËS PËR ÇDO PËRDORIM TË INFORMACIONIT QË PËRMBAN.”

Përmbajtja

Hyrje	6
1. Përkufizim i termave e koncepteve kryesore mbi të cilët ngrihet e zhvillohet ky studim....	7
2. Analizë i zonave të mbrojtura që shtrihen brenda zonës së studimit	9
Parku kombëtar ‘Mali i Tomorrit’	9
Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.	11
Peizazhi i mbrojtur ‘Guri i Nikës – Valamarë’	11
Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.	13
Peizazhi i mbrojtur ‘Liqeni i Pogradecit’	13
Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.	17
Parku natyror ‘Stravaj – Sopot’	17
Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.	19
Parku natyror “Dardhë- Xhyrë”	19
Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.	21
Parku kombëtar “Shebenik”	21
Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.	23
3. Planifikimi dhe menaxhimi i territorit të zonës së studimit.....	25
Bashkia Skrapar.....	25
Vlerat natyrore të territorit.....	25
Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale	25
Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës	28
Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë	28
Bashkia Maliq	29
Vlerat natyrore të territorit të bashkisë.....	29
Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale	29
Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës	32
Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë	32
Bashkia Gramsh	33
Vlerat natyrore të territorit të bashkisë.....	33
Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale	33
Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës	35
Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë	36
Bashkia Pogradec	37
Vlerat natyrore të territorit të bashkisë.....	37
Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale	37

Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës	39
Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë, me fokus:	40
Bashkia Prrenjas.....	41
Vlerat natyrore të territorit të bashkisë.....	41
Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale	41
Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës	43
Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë, me fokus:	43
Bashkia Librazhd	44
Vlerat natyrore të territorit të bashkisë.....	44
Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale	44
Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës	46
Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë me fokus:	47
<i>Mjedisi, aspekte kryesore të tij në zonën e studimit</i>	<i>47</i>
Mjedisi, konsiderata dhe fokusi i këtij studimi mbi të	47
Problematikat shqetësuese mjedisore që ndikojnë edhe në funksionin e zonës si rjet ekologjik.	48
Pikat e nxehta mjedisore (hotspotet)	50
<i>4. Prezantimi i NBS (Nature Based Solutions), si një mjet planifikues për minimizimin e impakteve negative prej ndryshimeve klimatike dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.</i>	<i>52</i>
Paraqitje e ndryshimeve kryesore klimatike dhe e fenomeneve që lidhen me to e që rjedhin prej tyre, kryesisht në rajonin tonë	53
Ndryshimet kryesore klimatike	53
Pasoja e fenomeneve që shfaqen prej ndryshimeve klimatike	53
Aktivitete e masa që minimizojnë ose eliminojnë dukuritë negative që rjedhin prej ndryshimeve klimatike, nëpërmjet aplikimit të NBS (ZBN).....	54
<i>Bibliografi</i>	<i>56</i>

Tables

Table 1. Të dhëna përmbledhëse, Parku Kombëtar ‘Mali i Tomorrit’	9
Table 2. Të dhëna përmbledhëse peizazhi i mbrojtur ‘Guri i Nikës – Valamarë’	11
Table 3. Të dhëna përmbledhëse, Peizazhi i mbrojtur Liqeni i Pogradecit.....	13
Table 4. Të dhëna përmbledhëse, Parku Natyror Stravaj - Sopot.....	17
Table 5. Të dhëna përmbledhëse, Parku Natyror Dardhe - Xhyre	19
Table 6. Të dhëna përmbledhëse, Parku Kombëtar Shebenik Jabllanice	21
Table 7. Të dhëna mbi fondin pyjor, Bashkia Skrapar	26
Table 8. Të dhëna mbi fondin kullosor, Bashkia Skrapar	26

Table 9. Të dhëna mbi fondin pyjor, Bashkia Maliq	30
Table 10. Të dhëna mbi fondin kullosor, Bashkia Maliq	31
Table 11. Të dhëna mbi fondin pyjor, Bashkia Gramsh	33
Table 12. Të dhëna mbi fondin kullosor, Bashkia Gramsh	34
Table 13. Të dhëna mbi fondin pyjor, Bashkia Pogradec	37
Table 14. Të dhëna mbi fondin kullosor, Bashkia Pogradec.....	38
Table 15. Të dhëna mbi fondin pyjor, bashkia Prrenjas.....	41
Table 16. Të dhëna mbi fondin kullosor, Bashkia Prrenjas	42
Table 17. Të dhëna mbi fondin pyjor, Bashkia Librazhd	44
Table 18. Të dhëna mbi fondin kullosor, Bashkia Librazhd	45

Hyrje

Qëllimi i këtij raporti është të analizojë zhvillimin aktual të zonës së projektit që përfshin një pjesë të korridorit ekologjik Polis-Valamarë-Rungaje-Moravë-Gramoz. Fokusi i analizës është vlerësimi i zhvillimit, planifikimit dhe menaxhimit aktual të territorit, strategjitë në nivel planifikimi për secilën bashki dhe menaxhimi i sistemit të zonave të mbrojtura përfshirë fonfin pyjor e kullosor. Gjithashtu në këtë raport bëhet një vlerësim i shkurtër i zbatimit të Nature Based Solution (NBS) në përgjigje të ndryshimeve klimatike.

Zona në studim (në vijim CCA) kufizohet në pjesën veriore me Parkun Kombëtar Shebenik dhe Jug-Lindje me Parkun Kombëtar të Tomorrit. Në pjesën lindore korridori kufizohet nga Peizazhi i Mbrojtur Liqeni i Pogradecit. Në këtë zonë përfshihen 6 zona të mbrojtura, specifiku: Parku Kombëtar Shebenik, Parku Natyror Stravaj-Sopot, Peizazhi i mbrojtur Liqeni i Pogradecit, Peizazhi i mbrojtur Guri i Nikës, Parku Natyror Mali i Tomorrit dhe Parku Natyror Dardhë-Xhyrë. Gjithashtu zona në studim prek territorin e tre qarqeve Korçë, Berat dhe Elbasan, dhe gjashtë bashkive: Librazhd, Prrrenjas, Pogradec, Gramsh, Maliq, Skrapar.

Kapitulli i parë i këtij studimi prezanton disa terma që gjejnë përdorim në studim, me qëllim që të kuptohet qartazi përmbajtja dhe objekti i tij. Merret në studim një pjesë e territorit të vendit, respektivisht në jug-lindje të tij, me një këndvështrim specifik, rrjeti ekologjik i tij.

Kapitulli i dytë prezanton në mënyrë të përmbledhur zonat e mbrojtura pjesë e zonës së studimit, specifiku vlet natyrore, sipërfaqe dhe zonim i ZM, përdorimi dhe menaxhimi i territorit etj. Zonat janë prezantuar sipas drejtimit Jug – Veri (me specifiku në drejtimin jug-lindje-veri-perëndim, sipas rrjedhjes së lumenjve të zonës së studimit).

Kapitulli i tretë prezanton në mënyrë të përmbledhur planifikimin dhe menaxhimin e territorit të zonës së studimit. Duke vlerësuar gjithë pjesën tjetër të territorit të zonës së studimit veç zonave të mbrojtura, në cilësinë e korridorëve ekologjike, trajtimi i këtij kapitulli të studimit bëhet veçmas për çdo bashki që gjendet plotësisht ose pjesërisht brenda zonës së studimit. Renditja e tyre do të ndjekë drejtimin Jug – Veri, Skrapar (pjesa veriore e bashkisë), Maliq, Gramsh (pjesa lindore e bashkisë), Pogradec, Prrrenjas, Librazhd (pjesa jugore e bashkisë). Për secilën bashki prezantohen vlerat natyrore, sistemet e përdorimit të tokës, menaxhimi i burimeve natyrore pyje, kullota, toka bujqësore, burime ujore, burime minerare. Gjithashtu pjesë e studimit është një analizë e planit të përgjithshëm vendor për secilën bashki, specifiku me fokus drejtimet kryesore të zhvillimit, projektet kryesore që planifikohet të zhvillohen në infrastrukturë, industri dhe impakti i mundshëm i tyre në raport me ruajtien e biodiversitetit dhe funksionin e territorit si korridor ekologjikë.

Ky studim përfundon me një përmbledhje të shkurtër të rekomandimeve mbi ndërhyrjet e mundshme sipas NBS, për të adresuar ndryshimet klimatike të cilat kërcënojnë në mënyrë të rëndësishme këtë korridor ekologjik.

1. Përkufizim i termave e koncepteve kryesore mbi të cilët ngrihet e zhvillohet ky studim.

Ekologji: Përkufizimi i konceptit 'Ekologji' ndihmon për shpjegimin e gjithë termave në vijim. Disa përkufizime që shpjegojnë këtë term janë:

- a. Ekologjia është shkencë që studion ndërveprimin e një organizmi me mjedisin rrethues biotik (jeta e gjallë) dhe abiotik (mjedisi fizik).
- b. Ekologjia mund të përkufizohet si një pjesë e biologjisë. Ajo përfshin marrëdhëniet reciproke midis mjedisit të gjallë dhe atij jo të gjallë, pra midis qënieve të gjalla dhe klimës, tokës, ujit dhe ajrit.

Qëndrueshmëria ekologjike: Qëndrueshmëria ekologjike (apo ekologji e qëndrueshme) përshkruan sjelljen afatgjatë dhe të kujdesshme të burimeve natyrore (të shterrueshme).

Qendër ekologjike: Koncepti i bioqendrës lidhet me një territor të caktuar me karakteristika fizike homogjene ku zhvillohet një ose disa ekosisteme specifike që së bashku mundësojnë zhvillimin e plotë të një bashkësie të caktuar organizmesh dhe që dallon nga mjedisi rrethues. E rëndësishme është të sqarohet se koncepti i qendrës ekologjike vjen si zhvillim dhe zgjerim i konceptit të bioqendrës, pasi në këtë të fundit vëmendja i kushtohet biodiversitetit kryesisht kurse tek qendra ekologjike përmbahet edhe mjedisi fizik, abiotik. Në këtë studim, pranohen si qendra ekologjike, zonat e mbrojtura.

Korridor ekologjik: Korridori ekologjik është hapësira territoriale midis qendrave ekologjike që siguron lidhjen e popullatave të specieve apo individëve të tyre. Biokorridori zakonisht nënkupton rrugën që zgjedhin kryesisht gjitarët e mëdhenj për të kaluar nga një qendër ekologjike në tjetrën. Korridori ekologjik është jetik për biodiversitetin sepse mundëson së pari, arealin e përhapjes dhe jetesës së gjitarëve të mëdhenj, të cilët kërkojnë një hapësirë territoriale më të madhe apo shumë më të madhe se çfarë ofron një qendër ekologjike në zonën tonë të studimit (si i kemi konceptuar në këtë studim, pra një zonë e mbrojtur me sipërfaqe të nivelit nga një në disa mijra hektarë). Së dyti, një gjitar i madh, duke qëndruar në krye të zinxhirit të të ushqyerit, lëviz nga një qendër ekologjike në rastet kur hallkat që vijnë poshtë tij, pra ato lloje që shërbejnë si ushqim për të mungojnë, kanë mbaruar dhe, largimi i përkohshëm i tyre jep mundësi të rikuperohen këto hallka dhe të rivendoset kështu ekuilibri biologjik. Ky ekuilibër në këtë rast rivendoset nga vetë natyra dhe siguron qëndrueshmërinë biologjike dhe ekologjike.

Rrjet ekologjik: Në mënyrë të thjeshtuar dhe konkrete rrjeti ekologjik përfaqëson qendrat ekologjike dhe korridoret ekologjike së bashku, pra përfshin gjithë zonën e studimit.

Zgjidhjet e bazuara tek natyra (NBS): Përkufizim i konceptit sipas IUCN: *NBS janë veprime të cilat mbrojnë, menaxhojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe restaurojnë ekosistemet qofshin ato natyrore apo të modifikuara, në mënyrë të tillë duke adresuar në mënyrë efikente dhe përshtatur sfidat shoqërore, duke ofruar mirëqenie për njerezit njëkohësisht dhe ruajtien e biodiversitetit¹.*

¹ "Nature-based Solutions are actions to protect, sustainably manage and restore natural and modified ecosystems in ways that address societal challenges effectively and adaptively, to provide both human well-being and biodiversity benefits" (IUCN, 2016)

Në një vazhdim të shtjellimit të konceptit, Zgjidhjet e Bazuara tek Natyra janë menaxhimi i qëndrueshëm dhe përdorimi i proceseve dhe veçorive të natyrës për të trajtuar çështjet social-mjedisore. Këto çështje përfshijnë ndryshimet klimatike, sigurinë e ujit, ndotjen e ujit, sigurinë e ushqimit, shëndetin njerëzor, humbjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e riskut të shkatërrimeve. Zgjidhjet e bazuara tek natyra grupohen në tre tipe: Ndërhyrje minimale në ekosistemet, ndërhyrje të vogla në ekosisteme dhe peizazhe, dhe menaxhim intensiv i ekosistemeve.

Zonë e mbrojtur është një hapësirë tokësore, ujore, detare e bregdetare, e përcaktuar qartë gjeografikisht, e njohur, me kufij të qartë fizikë dhe e menaxhuar përmes mjeteve ligjore apo mjeteve të tjera të efektshme, për të arritur ruajtjen/mbrojtjen afatgjatë të natyrës, e lidhur me shërbimet e ekosistemit dhe të vlerave kulturore.

Punime të inxhinierisë biologjike përfshijnë kategori punimesh si: mbjellje bimësh drunore apo shkurre me system rrënjor xhufkor që ndihmon në stabilizimin e terreneve të rëshqitshëm, jo kompaktë, sistemim i shpateve të pjerrët e mbjellje e tyre me bar e shkurre, aplikim i gjerdheve çift si masë mbrojtëse ndaj erozionit, mure guri të thatë me kalema shëlgjesh apo shkurre të mbjella në fugat e tyre, etj, në thelb pra aplikim masash në imitim të natyrës me lëndë të parë natyrore, kryesisht material biologjik.

2. Analizë e zonave të mbrojtura që shtrihen brenda zonës së studimit

Zonat e mbrojtura pjesë e këtij studimi do të prezantohen shkurtimisht me të dhënat e grupuara sipas nënpikave të kapitullit 2. Zonat do të renditen sipas drejtimit Jug – Veri (në këtë drejtim, më specifikisht në drejtimin jug-lindje-veri-perëndim, janë rjedhjet e lumenjve të zonës së studimit, prandaj ndiqet kjo renditje). Në mënyrë të detajuar, të zbërthyer në elementët përbërës, në formë konçize, duke paraqitur gjithë përmbajtjen që kërkon kapitulli 2 me nënpikat e tij, çdo zonë e mbrojtur do të paraqitet në vijim në formën e një tabele.

Parku kombëtar ‘Mali i Tomorrit’

TABLE 1. TË DHËNA PËRMBLEDHËSE, PARKU KOMBËTAR ‘MALI I TOMORRIT’

Nr	Emërtimi i të dhënës	Vlerësimi si sasi ose me fjalë	Shënime të veçanta
1	Vlerat natyrore kryesore të zonës së mbrojtur	Parku dallohet për biodiversitet të theksuar: shkurre mesdhetare, dushqe, ahishte, halorë dhe kullota subalpine e alpine. Bimësia përfaqësohet nga të 4 katet bimore të vendit. Parku dallohet për botë shtazore shumë të larmishme: Gjenden 11 lloje amfibësh, 141 lloje shpendesh, 34 lloje gjitaresh. Janë evidentuar 16 tipe habitesh natyror të rëndësishëm, nga të cilët 5 janë habitate parësore. Parku dallohet për një larmi e jashtëzakonshme të florës e faunës. Janë evidentuar: 22 lloje floristike të rëndësishme (5 lloje me mbrojtje ndërkombëtare), 18 lloje endemike, 2 lloje i përkasin Aneksit IV, të Direktivës së Habitatit; 1 lloj, të Konventës së Bernës dhe 1 lloj, të Listës së Kuqe të IUCN-s. Gjithashtu, janë evidencuar llojet faunistike të Listës së IUCN-s, ku: 1 lloj Të rrezikuar, 12 lloje Thuajse të rrezikuar, 8 lloje Vulnerabile, 56 lloje Jo shqetësuar.	
a	Sipërfaqja e përgjithshme	27 158.5 ha	
b	Vlerat më të spikatura natyrore (dy-tre prej tyre që i japin emër zones, që i kanë dhënë statusin e zones së mbrojtur)	Mali madhështor i Tomorrit, lumi i Tomorricës. Në park gjenden 12 monumente natyre, habitatet e shumta, speciet e shumta bimore e të faunës, peizazhet malore-shkëmbore, burimet ujore të Bogovës.	
2	Përdorimi i territorit		
a	Kullota	1 186.4 ha	
b	Pyje	22 842.5 ha	Përbërja e fondit pyjor të Parkut është: 9 758.7 ha pyje + rreth 1 182.6 ha sipërfaqe me vegetacion

			të pakët, + 11 881.2 ha shkurrishte
c	Tokë bujqësore	3 039.6 ha	Përbërja e fondit të tokës bujqësore është: 2758.6 ha tokë heterogjene bujqësore + 271 ha tokë bujqësore.
d	Habitat i terreneve të lagësht		
e	Sipërfaqe ujore	Rreth 20 ha	
f	Sipërfaqe e banuar	100 ha	
3	Struktura e pyjeve: Pyje halorë: Fletorë; Të përzier Cungishte: Trungishte: Shkurre	Pyje ahu + pyje pishë, pak pyje të përzier + shkurre në sip. të madhe.	
4	Biodiversiteti		
a	Numri i ekosistemeve	5	
b	Numri i specieve bimore (flora)		
c	Numri i specieve të faunës	Përfaqësohet prej një pasurie faune, mjafton të theksojmë që vetëm vertebrorët e mëdhenj janë prezent në larminë e tyre që nga peshqit, amfibët, reptilët, shpendët e gjitarët	
d	Numri i habitateve (sa prej tyre me rëndësi të veçantë)	Janë të veçanta ato të terreneve shkëmbore.	
e	Të dhëna të veçanta për larminë gjenetike		
5	Menaxhimi e monitorimi i zonës së mbrojtur (ekzistenca ose jo e Planit të Menaxhimit zonimi, etj.)		
6	Menaxhimi i zones së mbrojtur, ka apo nuk ka plan menaxhimi	Ka pasur plan menaxhimi 5 vjeçar 2014 - 2019	Nevojitet plan i ri menaxhimi.
7	Sipërfaqja dhe struktura e nënzonës qendrore (sa pyje, sa kullota, sa sipërfaqe tjetër)	7 484.4 ha, fond pyjor	
8	Aktivitetet menaxhues në zonën e mbrojtur,		
9	Aktivitete monitories	Kryhet rregullisht monitorimi i faunës nga personeli i AdZM Berat	
10	Sjellja e komunitetit që jeton brenda zonës së mbrojtur		

	Evidentim i problematikave kryesore aktuale lidhur me biodiversitetin		
11	Shqetësimet kryesore që vijnë nga komuniteti	Vizitorët e shumë fetarë gjatë pelegrinazhit; aktiviteti i guroreve, prerjet e paligjshme në pyje, fragmentimi i madh i Parkut prej popullsisë, qendrave të banuara, copëzave të tokës bujqësore.	
12	Zhvillimi i ekoturizmit në zonë (i madh dhe agresiv, mesatar, i pakët)	Mali i Tomorrit me relievin e tij të larmishëm ofron mundësi të shumta për ekoturizëm, por përdoret kryesisht për pelegrinazhin tek varri i Abaz Aliut.	Mund të zhvillohen sportet e ecjes në këmbë në shtigje të vështirësive të ndryshme, skive, alpinizmit, etj.

Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.

1. Mbrojtja e Parkut kombëtar, si një hapësirë e copëzuar si në pikpamje të dinamikës së relievit ashtu edhe të përhapjes së qendrave të vogla të banuara, përbën një sfidë serioze për AdZM Berat. Kjo mund të arrihet nëse kthehet po aq edhe detyrë e komuniteteve që jetojnë në Park. Duhet ndërgjegjësim dhe ftesë e vazhdueshme për mbrojtje të përbashkët.
2. Vetë natyra e territorit të Parkut, krijon mundësi të shumta të zhvillimit të ekoturizmit në pjesën e sipërme të Parkut, në pyjet e livadhet e tij, ashtu edhe të zhvillimit të agroturizmit në shtëpitë e banorëve lokalë.
3. Lëvizjet e shumta në Park (rasti i pelegrinazhit), coptimi i madh i tij, prania e popullsisë, janë faktorë të mëdhenj të shqetësimit të biodiversitetit. Për këto arsye, të synohet krijimi i një sipërfaqeje prej 26 % të sip. së Parkut, si një hapësirë e qetë (pra flitet për nënzonën qendrore të Parkut. Krahas mbrojtjes prej personelit, rekomandohen edhe dy masa: sinjalistika rrethuese e nënzonës qendrore të Parkut; devijimi i gjithë shtigjeve të ecjes, rrugëve rurale dhe rrugëkalimeve të bagëtive prej këtij territori dhe në afërsi të tij.

Peizazhi i mbrojtur ‘Guri i Nikës – Valamarë’

TABLE 2. TË DHËNA PËRMBLEDHËSE PEIZAZHI I MBROJTUR ‘GURI I NIKËS – VALAMARË’

Nr	Emërtimi i të dhënës	Vlerësimi si sasi ose me fjalë	Shënime të veçanta
1	Vlerat natyrore kryesore të zonës së mbrojtur		
a	Sipërfaqja e përgjithshme	5 172.7 ha	
b	Vlerat më të spikatura natyrore (dy-tre prej tyre që i japin emër zonës, që i kanë dhënë statusin e zonës së mbrojtur)	Ka 4 monumente natyre, 2 në Lenije (veçohen liqenet akullnajore) dhe 2 në Grabovë, gjendet në mes të masiveve pyjorë dhe pranë	

		kanionit të Llëngës, ka biodiversitet të lartë, një degë e lumit Shkumbin kalon prej brenda saj, nga edhe buron dhe vazhdon në kufi të saj	
2	Përdorimi i territorit		
a	Kullota (me pjesëmarrje modeste të shkurreve)	2 930.5 ha	
b	Pyje	2083.4 ha	
c	Tokë bujqësore	51 ha	
d	Habitat i terreneve të lagësht		
e	Sipërfaqe ujore	7.8 ha	Liqenet akullnajore të Lenijes
f	Sipërfaqe e banuar		
3	Struktura e pyjeve: Pyje halorë: Fletorë; Të përzier Cungishte: Trungishte		
4	Biodiversiteti	Nuk është studiuar	
a	Numri i ekosistemeve	3	
b	Numri i specieve bimore (flora)		
c	Numri i specieve të faunës	Janë të pranishëm gjitarët e mëdhenj. Si një zonë e pabanuar, e vendosur mes masiveve pyjorë të Gurit të Nikës, Qafë-Panjës, Bishnicës është një bioqendër e shkëlqyer për faunën e egër	
d	Numri i habitateve (sa prej tyre me rëndësi të veçantë)		
e	Të dhëna të veçanta për larminë gjenetike	Robulli në Lenije përbën një burim gjenetik me vlerë.	Robulli është i vendosur në arealin natyror të vet, në lartësitë 1800-2000m mbi nivelin e detit, në të katër kundrejtimet, në luginë e në shpate.
5	Menaxhimi e monitorimi i zonës së mbrojtur (ekzistenca ose jo e Planit të Menaxhimit zonimi, etj.)		
6	Menaxhimi i zonës së mbrojtur, ka apo nuk ka plan menaxhimi	Nuk ka plan menaxhimi	
7	Sipërfaqja dhe struktura e nënzonës qendrore (sa pyje, sa kullota, sa sipërfaqe tjetër)	1782.4 ha, kryesisht sipërfaqe pyjore.	
8	Aktivitetet menaxhues në zonën e mbrojtur,	Kryhen nga AdZM Korçë dhe Elbasan	

9	Aktivite monitorues	Kryhen nga AdZM Korçë dhe Elbasan, ku mbizotëron aktiviteti monitorues i faunës dhe aktiviteti monitorues i prerjeve të paligjshme në pyje.	
10	Sjellja e komunitetit që jeton brenda zonës së mbrojtur Evidentim i problematikave kryesore aktuale lidhur me biodiversitetin		
11	Shqetësimet kryesore që vijnë nga komuniteti	Prerjet e paligjshme në pyje, ndërtimi i HEC-eve në territorin e zm.	
12	Zhvillimi i ekoturizmit në zonë (i madh dhe agresiv, mesatar, i pakët)	Realizohen vetëm guida të pakta.	Potencial i lartë

Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.

1. Pavarësisht që zona e mbrojtur ka statusin ‘Peizazh i mbrojtur’, kat. V, sipas klasifikimit të IUCN, ajo ka kushte ideale të një bioqendre e më tej, të një qendre ekologjike, kryesisht për faunën e egër. Në mënyrën më të natyrshme prej saj marrin rrugë të sigurt disa korridore ekologjike. Pra, meriton një mbrojtje sa më të madhe.
2. Për HEC-et tashmë të ndërtuar e në funksionim, duhet që kompanitë të rehabilitojnë në maksimumin e mundshëm territoret e dëmtuar prej ndërtimit të tyre.

Peizazhi i mbrojtur ‘Liqeni i Pogradecit’

TABLE 3. TË DHËNA PËRMBLEDHËSE, PEIZAZHI I MBROJTUR LIQENI I POGRADECIT

Nr	Emërtimi i të dhënës	Vlerësimi si sasi ose me fjalë	Shënime të veçanta
1	Vlerat natyrore kryesore të zonës së mbrojtur	Vlerësimi si sasi ose me fjalë	Shënime të veçanta
		Peizazhi i mbrojtur i Pogradecit përbën një ekosistem natyror kompleks ujqor dhe tokësor. Përfshin disa nivele vegjetacioni të dalluara mirë, bazuar në kushtet klimatike dhe bio-fizike të zonës. Pyjet e lisit mbizotërojnë kodrat lindore të zonës dhe kodrat e Malit të Thate, si dhe pjesën e poshtme të kodrave në perëndim, në liqen, deri në 1,400m. Llojet e rëndësishme përfshijnë llojet e dushqeve si: <i>Quercus frainetto</i> , <i>Q. Pubescens</i> , <i>Q. Trojana</i> , <i>Q. Petrea</i> dhe <i>Q. cerris</i> ; llojet e tjerë: <i>Carpinus orientalis</i> , <i>Ostrya carpinifolia</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Prunus spinosa</i> dhe <i>Acer campestre</i> . Sidoqoftë, pasi një pjesë e madhe e tyre janë degraduar, habitatit pyjor është ndryshuar në shkurrë me gjelbërim të përhershëm të <i>Juniperus foetidissima</i> , <i>J. Oxycedrus</i> dhe <i>Buxus sempervirens</i> . Në zonat më të ftohta pylli i lisit plotësohet gjithashtu nga <i>Fraxinus excelsior</i> dhe <i>Acer opalus</i> subsp. <i>obtusatum</i> . Në lartësi 1,200m, në kodrat në perëndim të	

		<p>liqenit, peizazhi karakterizohet nga pylli i degjeneruar i Ahut (<i>Fagus sylvatica</i>), Lajthia (<i>Corylus avellana</i>) dhe Shkoza e zezë (<i>Carpinus orientalis</i>). Pylli i Gështenjës (<i>Castanea sativa</i>) mbizotëron në veri me shpatet e jugut drejt qytetit të Pogradecit dhe Buçimasit, kryesisht në kodrat afër Pogradecit, Verdovës, Gështenjasit dhe Leshnicës, në një lartësi mesatare midis 700-1,000m. Zonat malore të Malit të Thatë karakterizohen nga bimësia e kullotave malore dhe alpine, 1,800- 2,200m. Në livadhet alpine mbizotërojnë kryesisht llojet: <i>Arabis alpina</i>, <i>Aster alpinus</i>, <i>Achilea atrata</i>, <i>Festuca sp.</i>, <i>Nardus rrepta</i>, <i>Juniperus communis</i>, <i>Vaccinum myrtillus</i>, <i>Potentilla erecta</i>, etj. Bimët më të zakonshme mjekësore janë: <i>Gentiana lutea</i>, <i>Urtica dioica</i>, <i>Origanum vulgare</i>, <i>Thymus serpyllum</i>, <i>Trifolium campestre</i>, <i>Rosa canina</i>, <i>Salvia officinalis</i>, etj. Llojet më të shpeshta të gjitarëve në zonën janë: Lundërza (<i>Lutra lutra</i>), Ariu i murmë (<i>Ursus arctos</i>), Ujku (<i>Canis lupus</i>), Kaprolli (<i>Capreolus capreolus</i>), Derri i egër (<i>Sus scrofa</i>), të tjera dhe gjitarë më të zakonshëm janë: <i>Martes foina</i>, <i>Meles meles</i>, <i>Mustela nivalis</i>, <i>Vulpes vulpes</i>, <i>Sciurus vulgaris</i>, <i>Lepus europeus</i>, <i>Erinacues concolor</i>, <i>Glis glis</i>, <i>Apodemus flavicollis</i>, <i>A. sylvaticus</i>, <i>Talpa stankovici</i>, etj. Po kështu takohen edhe Lakuriqët kryesisht <i>Myotis nattereri</i>, <i>Nyctalus leisleri</i>, <i>Rhinolophus ferruequinum</i>, <i>R. blasii</i>.</p> <p>Në territorin e PM janë evidencuar: 13 tipe habitatesh natyror, sipas Listës së Habitave të Natura 2000, 12 lloje, floristike të rëndësishme dhe 9 lloje, endemike, 2 lloje, i përkasin aneksit IV, të Direktivës së Habitatit, dhe 1 lloj, Konventës e Bernës.</p> <p>Liçeni i Ohrit dallohet për numrin e lartë të llojeve endemike të algave një qelizore ose diatomeve me mbi 80 lloje. Në liçen rritet gjithashtu edhe një makro algë endemike, Shara e Ohrit (<i>Chara ohridana</i>), kurse në habitatet tokësore krahas llojeve obligate të mjediseve serpentiore <i>Festucops</i> i serpentinës (<i>Festucopsis serpentina</i>) gjenden edhe 3 lloje të tjera endemike: <i>Luleshurdha</i> (<i>Taraxacum ohritense</i>, <i>Taraxacum oppidanum</i> dhe <i>Taraxacum meyeri</i>).</p>	
a	Sipërfaqja e përgjithshme	27 723 ha	
b	Vlerat më të spikatura natyrore (dy-tre prej tyre që i japin emër zonës, që i kanë dhënë statusin e zonës së mbrojtur)	Liçeni i Ohrit dhe pellgu i tij ujëmbledhës, lidhja me liçenet e Prespës duke krijuar një makrosistem hidrologjik, me bruimet e shumta të Drilonit, Tushemishtit, etj. Për vlera të jashtëzakonshme natyrore (kriteri 7), pjesa shqiptare e liçenit, kompleksi ujqor i Drilonit dhe gadishulli i Linit i janë	

		bashkuar Sit-it të UNESCO-s të Ohrit (korrik 2019).	
2	Përdorimi i territorit		
a	Kullota	1 992 ha	
b	Pyje	8 997.9 ha	
c	Tokë bujqësore	4 530 ha	
d	Habitat i terreneve të lagësht	13 ha	
e	Sipërfaqe ujore	10 837.2 ha	
f	Sipërfaqe e banuar	592.43 ha	
3	Struktura e pyjeve: Pyje halorë: Fletorë; Të përzier Cungishte: Trungishte	Pyllëzime me pishë të zezë, pyje ahue, pyje dushqesh, pyje gështenje të butë, shkurrishte. Trungishte pyjet e pishës së zezë, cungishte pyjet fletorë.	
4	Biodiversiteti		
a	Numri i ekosistemeve	5	
b	Numri i specieve bimore (flora)	Flora dhe fauna ujore sh. e pasur, (rreth 1500 lloje), mbi 200 lloje endemike, prej tyre.	
c	Numri i specieve të faunës	17 lloje endemike peshqish, nga 21 lloje në liqen. Fauna tokësore 6 amfibë, 13 zvarranikë, 137 shpendë (ujorë e tokësorë), gjitarët të pastudiuar.	
d	Numri i habitateve (sa prej tyre me rëndësi të veçantë)	Habitat ujore, ligatinore, tokësore (pyjore, kullosore), etj.	
e	Të dhëna të veçanta për larminë gjenetike	Pyjet e gështenjës së butë, Castanea sativa, kanë vlera gjenetike.	
5	Menaxhimi e monitorimi i zonës së mbrojtur (ekzistenca ose jo e Planit të Menaxhimit zonimi, etj.)		
6	Menaxhimi i zonës së mbrojtur, ka apo nuk ka plan menaxhimi	Ka supplement të Planit të menaxhimit që konsideron marrjen e statusit të sit-it të UNESCO-s të një pjese të zones së mbrojtur, të vlefshëm deri në vitin 2027.	
7	Sipërfaqja dhe struktura e nënzonës qendrore (sa pyje, sa kullota, sa sipërfaqe tjetër)	1 211.47 ha	Përfshin dy sipërfaqe të vogla të liqenit, si vende riprodhimi të peshqve, sipërfaqe kullotash të Malit të Thatë që shkojnë deri në kufi me R. e

			Maq. së Veriut, duke shërbyer këto si biokorridore që lidhen me Parkun Kombëtar të Galicicës Maqedoni.
8	Aktivitetet menaxhues në zonën e mbrojtur,	Të shumta, edhe në liqen (mbarështimi i ihtiofaunës) edhe në pyje (agropylltaria, etj.), turizmi, etj.	
9	Aktivitete monitorues	Monitorimi i faunës, monitorimi i peshkimit të paligjshëm, prerjeve të paligjshme në pyje, etj.	
10	Sjellja e komunitetit që jeton brenda zonës së mbrojtur Evidentim i problematikave kryesore aktuale lidhur me biodiversitetin		
11	Shqetësimet kryesore që vijnë nga komuniteti	Ndotjet e ujit të liqenit, rrezik për biodiversitetin shumë të lartë të liqenit (shkarkimi i ujrave të ndotura që mbingarkojnë liqenin me nitratet, fosfatet, elementet minerare, ndotjet prej mbetjeve familjare). Prerjet e paligjshme në pyjet e zm. Kalimi i segmentit të rrugës nacionale Qukës – Qafë – Pllaçë, ka fragmentarizuar masivet pyjorë të gështenjës së butë dhe ka ndërprerë biokoridoret, ka dëmtuar peizazhin.	Dëmtuar janë veçanërisht pyjet e gështenjës – vazhdojnë ende të dëmtohen-, një nga elementët më me vlerë të peizazhit pyjor. Një shqetësim tjetër është gjendja tejet e infektuar nga procesionarja e pishës (Theumatopea) e gjithë sipërfaqeve të mbjella me pishë të zeze në këtë zonë të mbrojtur. Edhe sikur mos kishte asnjë person konkret dëmtues, prania në këtë zonë të mbrojtur e një popullsie të madhe (mbi ¾ e popullsisë së bashkisë Pogradec) përbën shqetësim serioz për biodiversitetin.
12	Zhvillimi i ekoturizmit në zone (i madh dhe agresiv, mesatar, i pakët)	Turizmi i plazhit në dy muajt e verës, korrik-gusht, është masiv, pra edhe agresiv. Ka rezerva të mëdha për zhvillimin e ekoturizmit, duke e kthyer këtë, së bashku me turizmin kulturor-historik, në turizëm gjithëvjetor dhe ekstensiv.	

Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.

1. Edhe pse zona e mbrojtur e ka brenda kufijve të vet, Plani i Menaxhimit në zonimin e brendshëm nuk e përfshin zonën e banuar; popullsia brenda kësaj zone të mbrojtur është e madhe (rreth 60 000 banorë) dhe e shpërndarë në territorin e saj, kështu që është faktor me peshë të jashtëzakonshme. Në qoftë se ky komunitet nuk ndërgjegjësohet që është pjesë organike e zonës së mbrojtur dhe duhet të jetojë e funksionojë në harmoni me natyrën e mjedisin rreth tij, kjo hapësirë nuk mund ta ruajë statusin e zonës së mbrojtur. Prandaj, duhet bashkëpunim i përhershëm ndërinstucional dhe me strukturat e shoqërisë civile e komunitetin e biznesit, ndërgjegjësim i gjithë komunitetit që ta konsiderojë veten bashkëmenaxhues të kësaj pasurie.
2. Specifikisht për këtë zonë të mbrojtur duhet pasur parasysh se ajo gëzon status të disafishtë: është zonë e mbrojtur e kategorisë së V sipas klasifikimit të IUCN, është pjesë e Rezervës Ndërkufitare të Biosferës Ohër – Prespë, një pjesë e zonës së mbrojtur është sit i UNESCO-s “Pasuri e Trashëgimisë Natyrore-Kulturore Botërore”. Edhe ky fakt ka rëndësi të jetë i mirënjohur prej institucioneve, pushtetit vendor, komunitetit, që për hir të të vërtetës, pak njihet.

Parku natyror ‘Stravaj – Sopot’

TABLE 4. TË DHËNA PËRMBLEDHËSE, PARKU NATYROR STRAVAJ - SOPOT

Nr	Emërtimi i të dhënës	Vlerësimi si sasi ose me fjalë	Shënime të veçanta
1	Vlerat natyrore kryesore të zonës së mbrojtur	Dallohet për diversitet të madh llojor e habitatore dhe për bimë endemike dhe subendemike, si: <i>Hypericum albanicum</i> dhe <i>Lilium albanicum</i> . Llojet kryesore bimore janë: <i>Fagus sylvatica</i> , <i>Quercus petraea</i> , <i>Quercus cerris</i> , <i>Abies alba</i> , <i>Pinus nigra</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Vaccinium vitis-idaea</i> , <i>Juniperus communis</i> , <i>Juniperus oxycedrus</i> , <i>Saturea montana</i> , <i>Hypericum albanicum</i> , <i>Genista sp.</i> , <i>Festucopsis serpentini</i> , <i>Pinus peuce</i> , <i>Pinus leucodermis</i> , <i>Euphorbia amygdaloides</i> , <i>Poa alpina</i> , <i>Rosa sp.</i> etj. Përbën një bërthamë dhe biokorridor për gjitarët e mëdhenj: Ariun (<i>Ursus arctos</i>), Ujkun (<i>Canis lupus</i>), Rrëqebullin (<i>Lynx lynx</i>), Dhinë e egër (<i>Rupicapra rupicapra</i>), Kaprollin (<i>Capreolus capreolus</i>) etj. Bazuar në përditësimet e fundit (Nëntor 2019) në territorin e PN janë evidentuar: 4 tipe habitatesh natyror. Gjithashtu, janë evidentuar llojet faunistike të Listës së IUCN-s, ku: 1 lloj Të rrezikuar, 8 lloje Thuajse të rrezikuar, 6 lloje Vulnerabile, 50 lloje Jo shqetësuar.	
a	Sipërfaqja e përgjithshme	1549 ha	
b	Vlerat më të spikatura natyrore (dy-tre prej tyre që i japin emër zonës, që i kanë dhënë statusin e zones së mbrojtur)	Florë e pasur, rreth 28 % e florës së Shqipërisë, faunë e larmishme, prani e Riqebullit të Ballkanit, ka 3 monumente natyre.	
2	Përdorimi i territorit		
a	Kullota	-	

b	Pyje	1548 Ha	
c	Tokë bujqësore	1 ha	
d	Habitat i terreneve të lagësht	-	
e	Sipërfaqe ujore	-	
f	Sipërfaqe e banuar	-	
3	Struktura e pyjeve: Pyje halorë: Fletorë: Të përzier Cungishte: Trungishte	48 ha: 1500 ha :0 ha Trungishte 1533 ha, shkurre 15 ha.	Si në pyjet halorë ashtu edhe në ata fletorë ka prani të llojeve të tjerë në % të vogla Halorë: Pishë e zezë (lloji kryesor), bredhi bardhë, robull, arnen. Fletorë: Ah (lloji kryesor), dushqe, mëllezë, mështekën.
4	Biodiversiteti	I lartë dhe i qëndrueshëm	
a	Numri i ekosistemeve	2	
b	Numri i specieve bimore (flora)	Rreth 1080 lloje, e pastudiuar plotësisht	
c	Numri i specieve të faunës	247	
d	Numri i habitateve (sa prej tyre me rëndësi të veçantë)	15 3	
e	Të dhëna të veçanta për larminë gjenetike	Nuk ka rezerva gjenetike të miratuara të llojeve drunorë,	Por në vendin e quajtur 'Gështenja e egër' ka pyje të vjetër ahu, si edhe bredhi të bardhë me arnen, ku mund të ketë material gjenetik me vlerë.
5	Menaxhimi e monitorimi i zonës së mbrojtur (ekzistenca ose jo e Planit të Menaxhimit zonimi, etj.)		
6	Menaxhimi i zonës së mbrojtur, ka apo nuk ka plan menaxhimi	Ka	
7	Sipërfaqja dhe struktura e nënzonës qendrore (sa pyje, sa kullota, sa sipërfaqe tjetër)	Ka nënzonë qendrore	Përgjithësisht respektohet mbrojtja, por kërkon më shumë punë.
8	Aktivitetet menaxhues në zonën e mbrojtur,	Dhënia në përdorim e sip. për qëllime turizmi etj.	
9	Aktivitete monitorues	Monitorim i habitateve/ llojeve floristike. Monitorim i faunës së eger me kamera kurth e sy të lire. Monitorim i aktiviteteve të	

		paligjshme, sidomos nënzona e përdorimit të qëndrueshëm	
10	Sjellja e komunitetit që jeton brenda zonës së mbrojtur Evidentim i problematikave kryesore aktuale lidhur me biodiversitetin		
11	Shqetësimet kryesore që vijnë nga komuniteti	Prerjet e paligjshme të materialit drunor.	
12	Zhvillimi i ekoturizmit në zonë (i madh dhe agresiv, mesatar, i pakët)	I pakët	

Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.

- Masivet pyjore të disa ekonomive pyjore në vazhdimësi, e bëjnë këtë zonë të mbrojtur një qendër të rëndësishme ekologjike dhe pikë kryqëzimi të disa korridoreve ekologjike që kalojnë qetësisht në mjedise pyjore-kullimore, me rjedhje ujore sipërfaqësore. Prandaj edhe rekomandohet një mbrojtje në shkallë të lartë e tyre.
- Vështirësi të madhe përbën fakti se pyjet e Stravajt dhe Sopotit janë shfrytëzuar tradicionalisht. Kalimi në zonë të mbrojtur e një pjese të dy ekonomive pyjore Stravaj dhe Sopot, rekomandohet të shoqërohet me fushata njohjeje prej komunitetit të këtij statusi mbrojtës dhe me sinjalistikë të dallueshme të kufijve të zm.

Parku natyror “Dardhë- Xhyrë”

TABLE 5. TË DHËNA PËRMBLEDHËSE, PARKU NATYROR DARDHE - XHYRE

Nr	Emërtimi i të dhënës	Vlerësimi si sasi ose me fjalë	Shënime të veçanta
1	Vlerat natyrore kryesore të zonës së mbrojtur	Ka vlera të larta biodiversiteti: pyje të virgjra, të dominuara nga Ahu, por takohen dhe drurë të tjerë. Zona përfaqëson një kombinim të pyjeve të dushkajave dhe të ahishtave. Dushkajat dominohen nga Qarri (<i>Quercus cerris</i>), që përzihet me Bungë (<i>Quercus petraea</i>) dhe në vendet e dëmtuara me Mëllezë (<i>Ostrya carpinifolia</i>) e Dëllinjë të kuqe (<i>Juniperus oxycedrus</i>) etj. Pyjet e Ahut (<i>Fagus sylvatica</i>) janë në gjendje thuajse të virgjër. Në çelirat e krijuara pas prerjes së drurëve të Qarrit përhapen masivisht individë të Badhrës (<i>Asphodelus albus</i>), të Dëllinjës së kuqe (<i>Juniperus oxycedrus</i>) dhe të Qumështores (<i>Euphorbia myrsinites</i>). Takohen bimë endemike e subendemike. Në të çarat e shkëmbinjeve takohen <i>Geranium macrorrhizum</i> , <i>Asplenium trichomanes</i> , <i>Saxofraga paniculata</i> ,	

		Athamantha Achillea frasi etj. Është bërthamë dhe biokorridor i gjitarëve të mëdhenj, me rëndësi rajonale/ballkanike si: Ariu (Ursus arctos), Ujku (Canis lupus), Rrëqebulli (Lunx lynx), Dhia e egër (Rupicapra rupicapra), etj. Sa l takon llojeve faunistike, që frekuentojnë zonën, mendohet: 1 lloj l rrezikuar, 8 lloje Thuajse të rrezikuar, 6 lloje Vulnerabile, 46 lloje Jo të shqetësuar.	
a	Sipërfaqja e përgjithshme	400.3 ha	
b	Vlerat më të spikatura natyrore (dy-tre prej tyre që i japin emër zonës, që i kanë dhënë statusin e zonës së mbrojtur)	Biodiversitet i pasur, 12% e florës shqiptare; Fauna e larmishme, prania e gjitarëve të ndryshëm.	Konsiderohet zonë e mbrojtur me biodiversitet të lartë sepse kjo pasuri specimesh gjendet vetëm në një sipërfaqe të vogël: 400 ha.
2	Përdorimi i territorit		
a	Kullota	-	
b	Pyje	400 ha	
c	Tokë bujqësore	-	
d	Habitat i terreneve të lagësht	-	
e	Sipërfaqe ujore	-	
f	Sipërfaqe e banuar	-	
3	Struktura e pyjeve: Pyje halorë: Fletorë: Të përzier Cungishte: Trungishte	0: 100: 0 0: 100	Janë pyje ahu me pjesëmarrje të vogla të llojeve si bredh i bardhë, panjë mali, ajdes i rëndomtë, etj.
4	Biodiversiteti	I lartë në elementin specie	
a	Numri i ekosistemeve	1	
b	Numri i specieve bimore (flora)	380 specie, e pastudiuar specifikiisht flora	
c	Numri i specieve të faunës	116 specie, e pastudiuar specifikiisht fauna.	
d	Numri i habitateve (sa prej tyre me rëndësi të veçantë)	5, asnjë i rëndësie të veçantë	Nuk ka prej listës së IUCN, të cilësuar si të tillë.
e	Të dhëna të veçanta për larminë gjenetike	Nuk ka	
5	Menaxhimi e monitorimi i zonës së mbrojtur (ekzistenca ose jo e Planit të Menaxhimit, zonimi, etj)		
6	Menaxhimi i zonës së mbrojtur, ka apo nuk ka plan menaxhimi	Nuk ka plan menaxhimi	
7	Sipërfaqja dhe struktura e nënzonës qendrore (sa pyje, sa kullota, sa sipërfaqe tjetër)	Nuk ka zonim të brendshëm	Por zona ka një avantazh, ndodhet brenda një ekonomie pyjore, pra rrethohet nga pyje.

8	Aktivitetet menaxhues në zonën e mbrojtur,	Nuk ka	
9	Aktivitetet monitorues	Monitorohen flora, fauna, habitatet, prej personelit, përdoren edhe kamera kurth.	
10	Sjellja e komunitetit që jeton brenda zonës së mbrojtur Evidentim i problematikave kryesore aktuale lidhur me biodiversitetin		
11	Shqetësimet kryesore që vijnë nga komuniteti	Nuk ka	
12	Zhvillimi i ekoturizmit në zonë (i madh dhe agresiv, mesatar, i pakët)	I pakët	

Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.

- Masivet pyjore të disa ekonomive pyjore në vazhdimësi, e bëjnë këtë zonë të mbrojtur një qendër të rëndësishme ekologjike dhe pikë kryqëzimi të disa korridoreve ekologjike që kalojnë qetësisht në mjedise pyjore-kullosore, me rjedhje ujore sipërfaqësore. Prandaj edhe rekomandohet një mbrojtje në shkallë të lartë e tyre.
- Vështirësi të madhe përbën fakti se pyjet e ekonomisë pyjore ‘Dardhë-Xhyrë’ janë shfrytëzuar tradicionalisht. Kalimi në zonë të mbrojtur e një pjese të saj, rekomandohet të shoqërohet me fushata njohjeje prej komunitetit të këtij statusi mbrojtës dhe me sinjalistikë të dallueshme të kufijve të zm.

Parku kombëtar “Shebenik”

Table 6. Të dhëna përmbledhëse, Parku Kombëtar Shebenik

Nr	Emërtimi i të dhënës	Vlerësimi si sasi ose me fjalë	Shënime të veçanta
1	Vlerat natyrore kryesore të zonës së mbrojtur	Zhvillohen të katër brezat bimorë të vendit: nënkati i Shibliakut, i shkurreve mesdhetare, Dushqe, Ahishte e Halorë dhe Kullota alpine. Ndër llojet kryesore të bimësisë përmendim, pyjet e virgjra të Ahut, me moshë mbi 140 vjet, të shoqëruar nga Bredhi i bardhë, Arneni, Frashri, Ajdësi, Ajshja, Mështekna dhe lloje me prani më të rrallë, si: Plepi, Shelgu, Panja e malitetj. Në zonën 1,300-1,800m, në kushte të temperaturave të ulëta dhe rreshjeve të bollshme ndeshen pyjet e Ahut (<i>Fagus sylvatica</i>), të shoqëruara kryesisht me bredh (<i>Abies alba</i>) dhe halorë të tjerë (<i>Pinus nigra</i> , <i>Pinus peuce</i> , <i>Pinus sylvestris</i>). Më shumë se 70% e llojeve të shpendëve janë të përhershme dhe më shumë se gjysma paraqesin interes të	

		veçantë për ruajtje. Këto të dhëna tregojnë vlera ornitologjike të veçanta dhe në të njëjtën kohë, një apel për masat ruajtëse të duhura për të mbrojtur këto vlera. Në park raportohen 10 lloje amfibësh dhe 15 lloje zvarranikësh, nga të cilët 4 lloje amfibësh dhe 11 lloje zvarranikësh i përkasin listës së Aneksit II të Konventës së Bernës.	
a	Sipërfaqja e përgjithshme	34 508 ha	
b	Vlerat më të spikatura natyrore (dy-tre prej tyre që i japin emër zonës, që i kanë dhënë stautsin e zonës së mbrojtur)	Siti i UNESCO-s ‘Pylli i vjetër i ahut Rajcë’; biodiversiteti i lartë në florë (33% e florës shqiptare) dhe faunë, prani e Riqebullit të Ballkanit, ka 15 monumente natyre.	Siti i UNESCO-s ‘Pylli i vjetër i ahut Rajcë’, e ka fituar këtë status pas studimesh të thelluara prej specialistëve të huaj dhe me mbështetje të specialistëve vendas. Janë pyje me prani drurësh ahu shumë të vjetër dhe me një vazhdimësi prej qindar vjetësh.
2	Përdorimi i territorit		
a	Kullota	6760 Ha	
b	Pyje	25769 ha	
c	Tokë bujqësore	1927 ha	
d	Habitat i terreneve të lagësht	pak njolla	
e	Sipërfaqe ujore	3 ha	
f	Sipërfaqe e banuar	49 ha	
3	Struktura e pyjeve: Pyje halorë: Fletorë: Të përzier Cungishte: Trungishte	1000 ha: 24769 Halorë: P. zezë, bredh i bardhë, robull, arnen; Fletorë: Ah, dushqe, mëllezë, mështekën Trungishte 14 000 ha; cungishte 6000 ha, Shkurrishte 5 769 ha	Si tek halorët ashtu edhe tek pyjet fletorë ka veç llojeve kryesorë, edhe lloje të tjerë në % të vogla
4	Biodiversiteti	I lartë dhe i qëndrueshëm	
a	Numri i ekosistemeve	3	
b	Numri i specieve bimore (flora)	33% e florës shqiptare, rreth 1180 lloje, 21 lloje kërpudhash, 3 lloje bimësh pa klorofil.	
c	Numri i specieve të faunës	Speciet e gjitarëve të mëdhenj 100%, 76% e gjitarëve të tjerë, amfibë, reptile, shpendë, insekte-flutura, 16 lloje lakuriq nate, etj. Rreth 270 lloje fauna	

d	Numri i habitateve (sa prej tyre me rëndësi të veçantë)	25,6 prej tyre të rëndësisë së veçantë (sipas klasifikimit të IUCN)	
e	Të dhëna të veçanta për larminë gjenetike	Pyjet e vjetër të ahut në Rajcë kanë vlera gjenetike specifike	Nuk janë të miratuara por kështu vlerësohen.
5	Menaxhimi e monitorimi i zonës së mbrojtur (ekzistenca ose jo e Planit të Menaxhimit zonimi, etj.)		
6	Menaxhimi i zonës së mbrojtur, ka apo nuk ka plan menaxhimi	Po, ka plan menaxhimi	
7	Sipërfaqja dhe struktura e nënzonës qendrore (sa pyje, sa kullota, sa sipërfaqe tjetër)	Nënzona qendrore A 2130 ha, nga kjo: 1600 ha pyje, 530 ha kullota. Nënzona qendrore B 14 532 ha, nga kjo: 14 000 ha pyje, 532 ha kullota.	
8	Aktivitetet menaxhues në zonën e mbrojtur,		
9	Aktivitete monitorues		
10	Sjellja e komunitetit që jeton brenda zonës së mbrojtur Evidentim i problematikave kryesore aktuale lidhur me biodiversitetin		
11	Shqetësimet kryesore që vijnë nga komuniteti		Edhe pse nuk raportohen, ka prerje të paligjshme të materialit drunor.
12	Zhvillimi i ekoturizmit në zonë (i madh dhe agresiv, mesatar, i pakët)		

Rekomandime lidhur me realizimin më mirë të rolit të qendrës ekologjike.

1. Marëdhënia AdZM Elbasan – komuniteti që banon brënda Parkut në dhjetra fshatra, për një menaxhim të qëndrueshëm të Parkut, është jetike për ekzistencën e tij. Është e rekomandueshme të ketë komunikim, bashkëpunim, bashkërendim.
2. Sigurimi i druve të zjarrit për popullsinë që jeton në territorin e Parkut, rekomandohet të realizohet në kuadër të punimeve silvikulturore në pyjet e Parkut, me miniprojekte teknike për çdo parcelë të planifikuar për ndërhyrje dhe në zbatim të Planit të menaxhimit të Parkut.
3. Mbrojtja e ZM në tërësi dhe sit-it të UNESCO-s (Pylli i vjetër i ahut Rajcë) dhe nënzonës qendrore në veçanti, merr një rëndësi të veçantë për zonën e këtij studimi edhe sepse përbën mjedisin komunikues

me Maqedoninë e veriut, respektivisht Parkun kombëtar të Mavrovos, ku tashmë dihet se gjendet Riqebulli i Ballkanit (si nënspecie e riqebullit, e pazyrtarizuar plotësisht).

3. Planifikimi dhe menaxhimi i territorit të zonës së studimit

Duke vlerësuar gjithë pjesën tjetër të territorit të zonës së studimit veç zonave të mbrojtura, në cilësinë e korridorëve ekologjike, trajtimi i këtij kapitulli të studimit bëhet veçmas për çdo bashki që gjendet e gjitha ose pjesërisht brenda zonës së studimit. Renditja e tyre do të ndjekë drejtimin Jug – Veri, Skrapar (pjesa veriore e bashkisë), Maliq, Gramsh (pjesa lindore e bashkisë), Pogradec, Prrenjas, Librazhd (pjesa jugore e bashkisë).

Bashkia Skrapar

Vlerat natyrore të territorit

Vlerat kryesore natyrore të territorit të bashkisë Skrapar janë:

1. Parku kombëtar i Tomorrit
2. Monumentet e natyrës
3. Parku natyror i Bogovës
4. Peizazhi i mbrojtur i kanioneve të Osumit dhe Gradecit
5. Parku kombëtar 'Bredhi i Hotovës – Dangëlli (pjesërisht shtrihet në territorin e bashkisë Skrapar por nuk përfshihet në zonën e studimit)
6. Pyjet e bashkisë Skrapar
7. Lumenjtë e Osumit, Çorovodës dhe Tomorricës

Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale

Sistemet e përdorimit të tokës

Sipas standartizimit të përdorimit të territorit dhe burimeve natyrore, territor i bashkisë Skrapar ndahet në pesë sisteme përdorimi ne përqindje si vijon:

1. Sistemi natyror (pyje kullota, etj) 82.99 %
2. Sistemi ujqor 1.41 %
3. Sistemi bujqësor 12.24 %
4. Sistemi urban 2.48 %
5. Sistemi infrastrukturor 0.89 %

Menaxhimi i burimeve natyrore pyje, kullota, toka bujqësore, burime ujore, burime minerale

Menaxhimi i pyjeve

Ekosistemi pyll është ekosistemi më kompleks i biodiversitetit dhe vendi i habitateve kryesore për faunën e florën dhe veçanërisht i gjitarëve të mëdhenj që janë në qendër të vëmendjes së këtij studimi. Ekosistemi pyll është gjithashtu ekosistemi që ofron shërbimet më të vlera mjedisore për cilësinë e ajrit, cilësinë e ujit nëntokësor dhe ujrave sipërfaqësore të rjedhshme e të qeta, për cilësinë e tokës dhe vetë procesin tokëformues, për klimën (mikroklimën specifike që krijon), për rekreacion dhe për biodiversitetin në elementet kryesorë të tij: habitate, lloje, materiali gjenetik. Bëmë këtë parashtrim të përmbledhur për të treguar rëndësinë e madhe të pyjeve dhe për të tërhequr vëmendjen e orgeneve të pushtetit vendor që, si pronarë dhe administratorë të pyjeve t'i kushtojnë përkushtimin dhe seriozitetin e duhur menaxhimit të qëndrueshëm të tyre. (Ky parashtrim i përket secilës nga 5 bashkitë e tjera në vijim, por nuk do të përsëritet).

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore të fondit pyjor bashkiak:

TABLE 7. TË DHËNA MBI FONDIN PYJOR, BASHKIA SKRAPAR

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia
1	Sipërfaqja e përgjithshme	24 500 ha
2	Tipet e grumbujve pyjorë	
3	Raporti cungishte: trungishte	1: 5
4	Raporti Pyje Fletorë: Halorë: Të përzier	4: 2: 1
5	Numri i ekonomive pyjore (sa kanë plan mbarështimi e sa nuk kanë)	7 Nuk ka asnjëra Plan Mbarështimi
6	Biodiversiteti në pyje (numur specimesh bimore, të dhëna për faunën, gjitarët e mëdhenj)	Janë të pranishëm gjitarët e mëdhenj si ariu, ujku, derri i egër, dhelpira, dhia e egër
7	Vlera natyrore të spikatura (shumë pak të tilla, çfarë u jep emër si krahinë)	Bukuritë e natyrës, ku theksojmë monumentet e natyrës si Kanionet e Osumit dhe Bokërrimat e Tomorricës
8	Dy – tre shqetësimet aktuale kryesore në pyjet e bashkisë	Mungesa e planeve të mbarështimit, mungesa e infrastrukturës, mungesa e specialistëve
9	Veprimet (ndërrhyrjet) menaxhuese aktuale në pyjet e bashkisë	Nuk janë bërë ndërhyrje përmirësuese, shkak – mungesa e fondeve

Mungon shfrytëzimi i pyjeve si aktiviteti kryesor silvikulturor pasi deri në vitin 2026 është në fuqi Ligji i Moratoriumit në Pyje. Por nga ana tjetër, çdo vit ndërhyhet kryesisht në pyjet cungishte me prerje për prodhimin e druve të zjarrit, popullsia fshatare i prodhon vetë. Hartohen miniprojekte punimesh përmirësuese por nuk kontrollohen dot të gjitha prej personelit pyjor dhe shpesh këto punime përmirësuese kthehen në përkeqësuese.

Menaxhimi i kullotave

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore për kullotat bashkiake

TABLE 8. TË DHËNA MBI FONDIN KULLOSOR, BASHKIA SKRAPAR

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia	Shënime
1	Sipërfaqja e përgjithshme	22 038 ha	
2	Struktura (kullota verore, livadhe etj)	20 772 ha kullota verore, 1 266 ha kullota dimërore	
3	Sipërfaqja aktuale që kullotet, numri i bagëtive që kullosin në një sezon	4500 – 6000 krerë (kullotet rreth 9000 – 10000 ha kullota verore, pra rreth 45% e kapacitetit)	Kapaciteti i lartë i papërdorur i kullotave verore, mundësi për të dyfishuar blegtorinë si aktivitet ekonomik prodhues.
4	Kullotja: E moderuar, Mbikullotet, Nuk kullotet	I – Kullotat verore: Kullotje e moderuar 45 %, nuk kullotet 55%. II – Kullotat dimërore: Mbikullotet	

5	A përbën shqetësim fauna e egër për bagëtinë	Nuk përbën	
---	--	------------	--

Aktiviteti i kullotjes së bagëtive zhvillohet intensisvisht në kullotat dimërore dhe në pyjet cungishte e shkurrishtet. Duke mos patur kullotje të kontrolluar, rotacion të rregullt të sipërfaqeve që kullotën, pra duke patur kullotje në çdo periudhë, ky fond pyjor dhe kullozor dëmtohet në mënyrë frekvente prej këtij aktiviteti.

Menaxhimi i tokës bujqësore

Sipërfaqja e tokës bujqësore të bashkisë është rreth 6806 ha. Kjo sipërfaqe parashikohet të zvogëlohet disi, pasi rreth 387 ha do të okupohen me ndërtime të reja si edhe prej ndërtimeve të segmenteve të rinj rrugorë, sipas PPV (ku pjesa më e madhe do të okupojë tokë bujqësore). Kryesisht zhvillohet bujqësi tradicionale, frutikulturë, vitikulturë, bimë të arrave, perime, foragjere për blegtorinë. Zhvillime të reja do të jenë mirëmbajtje dhe ndërtim sistemesh ujitëse, përmirësim cilësor i rrugëve dytësore (rurale), zhvillim i industrive ushqimore që do të rrisin vlerën e produkteve bujqësore.

Menaxhimi i burimeve ujore

Menaxhimi i burimeve ujore konsiston në mbrojtjen nga dëmtimet të ujrave sipërfaqësore, të rjedhshme dhe të qeta, që kapin 1.41% të territorit të bashkisë, ruajtjen dhe rritjen e cilësisë së ujit. Kanalizimi i ujrave të përdorura dhe ngritja e impiantit të trajtimit të tyre do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e cilësisë së ujit. Menaxhimi i integruar i mbetjeve do të zvogëlojë ndjeshëm ndotjet e ujit, sikundër ndodh sot ku në shumicën e fshatrave mbetjet hidhen në përroit më të afërt me fshatin. Disa punime që parashikohet të kryhen në mbrojtje prej përmytjeve të lumit Osum në afërsi të Çorovodës, kanë karakter ndërtimor, mure mbrojtës të brigjeve, gjurmime pastruese të shtratit të lumit, diga, etj, konsiderohen problematike. Këto ndërhyrje kanë denaturuar lumenjtë dhe kanë favorizuar dukuritë negative të gërryerjeve, përmytjeve, etj, kryesisht prej faktit se uji rrit shpejtësinë e levizjes së tij, pra rrit energjinë e vet kinetike. Zgjidhja që rekomandohet në këto raste është rinatyrimi i lumenjve me kryesisht dy masa – mbjellje drurësh e shkurrësh në shpatet e brigjet e lumenjve, rivlerësim i zgjerimeve që pëson natyrshëm shtrati i lumit, çlirim i tyre prej ndonjë objekti të ndërtuar, etj. dhe përkujdesje që këta ‘xhepa’ të luajnë rolin e rezervuarit të ujit në rast prurjesh të mëdha të ujit në lumë). Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit dhe menaxhimi i ujit të pijshëm në tërësi, janë një element tjetër i rëndësishëm i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore.

Menaxhimi i burimeve minerare

Punimet e industrisë nxjerrëse minerare kur zhvillohen në karrierë të hapur, dëmtojnë dukshëm peizazhin. Edhe rastet e shfrytëzimit me galeri, dëmtojnë peizazhin dhe fondin pyjor prej depozitimit në terren të hapur të materialeve sterile. Punimet në guroret gjithashtu shkaktojnë ndikimet negative në mjedis si: dëmtimi i peizazhit prej gjurmimeve e depozitimeve të materialeve sterile, dëmtim i fondit pyjor, eliminim i shtresës së tokës pyjore me gjithë bimësinë e instaluar në të, favorizohet ndjeshëm erozioni sipërfaqësor në gjithë sipërfaqen e aksidentuar prej punimeve minerare, materiali steril, me përmbajtje qoftë edhe në përqindje minimale të metaleve të rëndë dhe kriprave minerale acide, shoqërohen prej ujit të reshieve që krijon rjedhje sipërfaqësore dhe transportohen drejt përrenjve, lumenjve, rezervuarëve duke shkaktuar tek ta dy dëme, depozitim në shtretërit e tyre të materialeve dhe ndotjen kimike të ujrave të tyre. Këto aktivitete janë akoma më problematike kur kryhen në malin e Tomorrit, pra në afërsi të një zone të mbrojtur. Ndotje me shumë ndikim negativ që vjen prej këtyre aktiviteteve është edhe ndotja akustike,

një shqetësim serioz ky për faunën. Zhvillimi i tyre në sipërfaqe të vogla, kalimi nga një kantier në tjetrin duke rehabilituar kantierin e mbyllur, kufizon efektet negative të tyre.

Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës

Demografia

Popullsia e bashkisë Skrapar aktualisht 25134 banorë dhe me parashikim rreth 29 000 banorë në vitin 2030, ka një shpërndarje të rreth 1/3 së popullsisë në dy qendrat kryesore urbane Çorovodë dhe Bogovë dhe të pjesës tjetër në 8 njësi administrative dhe 101 fshatra. Pra, në zonat rurale ka fshatra me popullsi të vogla, në pjesën më të madhe me nga 50-150 banorë.

Aktivitetet kryesore ekonomike që zhvillon komuniteti

Në qytet popullsia zhvillon (edhe do të zhvillojë) aktivitet industrial kryesisht industri ushqimore-përpunim i produkteve bujqësore e blegtorale, ndërtim, shërbime, turizëm. Në zonat rurale popullsia zhvillon (edhe do të zhvillojë) kryesisht aktivitet bujqësor e blegtoral, gurore dhe miniera. Këto aktivitete lejohen të zhvillohen jo më afër se 200m nga zonat e mbrojtura. Aktiviteti i turizmit në përgjithësi, në qytet dhe në natyrë është i butë. Por ka dy momente ku ai kthehet në shqetësim për biodiversitetin, vizitat masive në Tomorr në raste festash dhe ushtrimi i sportit të kanoeve.

Shqetësimet në biodiversitet

1. Popullsia relativisht e vogël me shpërndarjen e saj në terren relativisht të madh (mbi 83 mijë ha) dhe sidomos në terrenet natyrore larg qendrave urbane, përbën shqetësim relativisht të vogël për biodiversitetin në tërësi dhe për gjitarët e mëdhenj në veçanti.
2. Ndër aktivitetet ekonomike, shqetësim serioz për biodiversitetin paraqesin dy prej tyre: aktiviteti i guroreve që zhvillohet rëzë malit të Tomorrit dhe vizitat masive prej mijra njerëzish në malin e Tomorrit, ne rast festash. Flasim për shqetësim të faunës së egër në një qendër të rëndësishme ekologjike (biologjike) sikundër është Parkun Kombëtar i Tomorrit.

Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë

Duke qënë se plani i përgjithshëm vendor përmban planifikimin e zhvillimit të bashkisë për 15 vitet e ardhshëm, është me vlerë studimi i tij dhe analizimi i zhvillimeve të pritshme.

Drejtimet kryesore (degët kryesore) të zhvillimit

Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, turizmit natyror (ekoturizmit).

Projektet kryesore që planifikohet të zhvillohen në infrastrukturë, industri

1. Ndërtim e rikonstrukcione rrugësh (mbi 95% e fondit të investimeve), konkretisht ndërtim / përmirësim i tre akseve rrugësh nacionale: aksi Çorovodë - Përmet, aksi Çorovodë - Korçë dhe aksi Çorovodë – Gramsh.
2. Mirëmbajtje e rrugëve dytësore që lidhin qendrën e bashkisë me qendrat e njësive administrative.
3. Ndërtimi i impiantit të pastrimit të ujrave të ndotura si edhe punime në sisteme ujitës, kanalizime të ujrave të përdorura.
4. Infrastrukturë e zhvillimit të turizmit, mirëmbajtje dhe reklamim i monumenteve natyrore, kulturore, fetare dhe përmirësim i infrastrukturës rrugore për aksesibilitetin e tyre.
5. Krijim zone ekonomike.

Shqetësimi i biodiversitetit prej zhvillimit të projekteve kryesore

1. Sipas pikës 1 më sipër: Aksi Çorovodë - Përmet nuk ka ndikim në zonën e studimit pasi ai zhvillohet në pjesën jugore të bashkisë Skrapar; aksi Çorovodë - Korçë shtrihet brenda territorit të Projektit por nuk bën pjesë në zonën e studimit; aksi Çorovodë - Gramsh shtrihet në zonën e studimit dhe në pjesën më të madhe të këtij segmenti (nga rreth 43 km që shtrihen në territorin e bashkisë Skrapar, vetëm në 2.2 km nuk do të ketë punime). Punimet në këtë aks do të krijojnë shqetësime për biodiversitetin si në kohën e punimeve ashtu edhe gjatë frekuentimit të rrugës. Ky ndikim rritet po të kemi parasysh që rruga zhvillohet afër Parkut Kombëtar të Tomorrit, në aksin e biokorridorit në drejtim të Parkut Kombëtar 'Shebenik – Jabllanicë'.
2. Mirëmbajtja e rrugëve dytësore, përmirëson qarkullimin, ul ndotjet në mjedis, por frekuentimi i shpeshtë rrit shqetësimet kryesisht tek fauna.
3. Pastrimi i ujrave të ndotura rrit cilësinë e ujrave në tërësi, ndikon pozitivisht tek biodiversiteti dhe ka një impakt mjaft pozitiv në mjedis.
4. Sipas pikës 4 më sipër: Ky projekt rrit turizmin por ul intensitetin e tij duke u shtrirë në shumë destinacione turistike. Shqetësimet në biodiversitet janë të balancuara, diku shtohen por diku gjatë ulet intensiteti.
5. Sipas pikës 5 më sipër: Projekti zhvillohet në qytet, pra nuk sjell shqetësime.

Vlerësim real i vazhdimësisë apo anasjelltas, i fragmentarizimit të biokorridoreve

Parashtrimi në përgjithësi i zhvillimeve në bashkinë Skrapar, aktuale dhe të pritshme në 10-15 vitet e ardhshëm, na jep mundësinë të arsyetojmë për fragmentarizim të biokorridoreve. Segmentet e rinj rrugorë, si shtesa të segmenteve aktuale (kur ka ndryshim apo shtesë gjurme), përbëjnë fragmentim të biokorridorit. Kjo do të ndodhë në dy akset rrugore Çorovodë – Korçë dhe Çorovodë – Gramsh.

Bashkia Maliq

Vlerat natyrore të territorit të bashkisë

Vlerat kryesore natyrore të territorit të bashkisë Maliq janë:

1. Parku Kombëtar i Prespës, një pjesë e vogël e tij
2. Parku natyror i Krastafillakut
3. Peizazhi i mbrojtur 'Guri i Nikës – Valamarë' (Pjesërisht - Lenia)
4. Monumentet e natyrës, 6 biotikë dhe 4 abiotikë, përmenden: Liqenet e Lenies, Robulli i Lenies, etj.
5. Lumi Devoll
6. Masivet pyjore të ahut Bofje
7. Fusha e Maliqit me dy veçoritë e saj, tokat torfike dhe një bërthamë kënetore

Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale

Sistemet e përdorimit të tokës

Sipas standartizimit të përdorimit të territorit dhe burimeve natyrore, territor i bashkisë Maliq ndahet në pesë sisteme përdorimi në përqindje si vijon:

1. Sistemi natyror (pyje kullota, etj) 71.81 %; (sipas PPV zvogëlohet me rreth 0.9%)
2. Sistemi ujqor 0.63 %; (rritet në 1.36 % për shkak të rezervuarit të HEC Moglicë)
3. Sistemi bujqësor 24.93 %;
4. Sistemi urban 2.31 %; (sipas PPV shkon 2.34 %)
5. Sistemi infrastrukturor 0.32 %

Menaxhimi i burimeve natyrore pyje, kullota, toka bujqësore, burime ujore, burime minerare
Menaxhimi i pyjeve

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore të fondit pyjor bashkiak:

TABLE 9. TË DHËNA MBI FONDIN PYJOR, BASHKIA MALIQ

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia
1	Sipërfaqja e përgjithshme	20 270 ha
2	Tipet e grumbujve pyjorë	Pyje ahu me pjesëmarrje të mëllezës, panjës së malit dhe bredhit të bardhë; Pyje dushqesh shparth, qarr, bungë, etj. me frashëer, shkozë, lajthi; Pyje pishe të zezë me hartinë; Pyje robulli.
3	Raporti cungishte: trungishte	67.6: 32.4 (2: 10,13303.8 ha: 6374.9 ha)
4	Raporti Pyje Fletorë: Halorë: Të përzier	78%: 11%; 11%
5	Numri i ekonomive pyjore (sa kanë plan mbarështimi e sa nuk kanë)	7 ekonomi pyjore të gjitha me plane mbarështimi të rinj.
6	Biodiversiteti në pyje (numur specimesh bimore, të dhëna për faunën, gjitarët e mëdhenj)	Me dhjetra specie të bimësisë drunore pyjore, ahu, pishat, dushqet, etj., shkurre të shumta si dëllinja, lajthi, fshikëkartha, kullumbri, etj., 8 reptilë, mbi 20 shpendë, 8 gjitarë, ku veç atyre të mëdhenj shtohet dhe iriqi, ka habitate ligatinore kryesisht me plep e shelg, me shpendë të këtyre terreneve, me amfibë, rreth 6specie, etj.
7	Vlera natyrore të spikatura (shumë pak të tilla, çfarë u jep emër si krahinë)	Shumëllojshmëria e bimësisë, diapazoni i gjërë në lartësi, reliev me thyerje shumë dinamike,
8	Dy – tre shqetësimet aktuale kryesore në pyjet e bashkisë	Prerjet e paligjshme në pyje, mungojnë investimet në infrastrukturë.
9	Veprimet (ndërrhyrjet) menaxhuese aktuale në pyjet e bashkisë	Pyllëzime 520 ha, të përfunduara; 515 ha punime përmirësuese si prerje sanitare dhe pastrime.

Mungon shfrytëzimi i pyjeve si aktiviteti kryesor silvikulturor pasi deri në vitin 2026 është në fuqi Ligji i Moratoriumit në Pyje. Por nga ana tjetër, çdo vit ndërhyhet kryesisht në pyjet cungishte me prerje për prodhimin e druve të zjarrit, popullsia fshatare i prodhon vetë. Hartohen miniprojekte punimesh, përmirësuese të gjitha në zbatim të planeve të menaxhimit, ku një pjesë e tyre kryhen edhe me subjekte private që kontraktohen nga bashkia, duke shërbyer këto punime edhe për sigurimin e druve të zjarrit për popullsinë e qytetit. Këtu, kontrolli e mbikqyrja e stafit teknik pyjor është e pranishme.

Menaxhimi i kullotave

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore për kullotat bashkiake

TABLE 10. TË DHËNA MBI FONDIN KULLOSOR, BASHKIA MALIQ

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia	Shënime
1	Sipërfaqja e përgjithshme	4540 ha	
2	Struktura (kullota verore, livadhe etj)	Kullota verore	
3	Sipërfaqja aktuale që kullohet, numri i bagëtimeve që kullosin në një sezon	500 ha	Kullotet rreth 10% (në kullotat verore), pra kapacitet i pashfrytëzuar 90%
4	Kullotja: E moderuar, Mbikullotet, Nuk kullohet	E moderuar	
5	A përbën shqetësim fauna e egër për bagëtinë	Jo, nuk ka dëme.	

Aktiviteti i kullotjes së bagëtimeve zhvillohet intensivisht në pyjet cungishte e shkurrishtet. Duke mos patur kullotje të kontrolluar, rotacion të rregullt të sipërfaqeve që kullohen, dhe për shkak të kullotjes në çdo periudhë, ky fond pyjor dëmtohet në mënyrë frekvente prej këtij aktiviteti.

Menaxhimi i tokës bujqësore

Bujqësia është një ndër aktivitetet prodhues më të rëndësishëm të bashkisë Maliq, fusha e Maliqit ka qënë tradicionalisht me rëndësi kombëtare për prodhimet bujqësore, kryesisht drithrat dhe panxharin e sheqerit. Zhvillimi aktual i bujqësisë ka karakteristika të re reformimin e strukturës së bimëve që kultivohen, e cila është shumë dinamike e variable pasi orientohet nga kërkesat e tregut dhe, një zhvillim të konsiderueshëm ka marrë frutikultura.

Problem kryesor i tokës bujqësore të fushës së Maliqit mbetet rreziku i përmbytjes së saj prej lumit Devoll. Ky fenomen vazhdon pasi toka në një masë të konsiderueshme është torfike (fusha e Maliqit u përfitua nga tharja e kënetës me të njëjtin emër) dhe ajo e ul nivelin e saj, në disa pjesë edhe në nivelin e fundit të shtratit të lumit Devoll që kalon përmes saj. Janë këto kushte që punimet kulluese, bonifikuese, ndërhyrjet edhe në shtratin e lumit Devoll, janë të përvitshme. Duke qënë toka pjellore, në bashkinë Maliq toka punohet, kultivohet, ka prodhime të pasura, pra bujqësia ka zhvillim të konsoliduar. Me rëndësi është angazhimi i bashkisë për zhvillimin e politikave nxitëse e mbështetëse në dy drejtime, përpunimin dhe rritjen e vlerës së produkteve bujqësore, standartizimin dhe krijimin e markave të produkteve bujqësore si mjet për sukses në tregun vendas, kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Menaxhimi i burimeve ujore

Bashkia Maliq ka burime të shumta ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Burimi ujqor kryesor dhe më i rëndësishëm në shumë aspekte është lumi i Devollit, i cili e përshkon territorin e bashkisë nga jug-lindja në veri-perëndim, duke krijuar ekosisteme e habitate natyrore specifike, me zhvillime horizontale në fushë dhe më pas bazene ujëmbledhës në pjesën perëndimore. Si rezultat i realizimit të projektit hidroenergjitik ‘Devollit Hydropower’, specifikisht i ndërtimit të digës para mbërritjes në Moglicë, tashmë është krijuar rezervuari i HEC-it Moglicë, i cili ka dyfishuar sipërfaqen ujore të bashkisë nga 0.63% të territorit të saj në 1.36%.

Fushën e Maliqit e përshkon pjesërisht edhe dega e lumit Devoll – Dunavecit, i cili derdhet në Devoll pikërisht në këtë fushë. Bashkia përshkohet gjithashtu prej përenjsh e proskash të shumta që derdhen në Devoll. Liqenet e Lenies, që gjenden në lartësitë 1800 – mbi 2000 metra mbi nivelin e detit, shtojnë pasuritë ujore të bashkisë duke i dhënë një vlerë të veçantë natyrore dhe një pike tërheqëse turistike. Këta liqene janë një burim i rëndësishëm ujëpirjeje për gjitarët e mëdhenj në qendrën ekologjike ‘Guri i Nikës – Valamarë. Ujrat freatike në fushën e Maliqit gjenden relativisht lart, afër sipërfaqes, duke variuar nivelin e tyre në vartësi të reshieve, duke arritur të dalin diku edhe në sipërfaqe ku krijojnë pjesë të përmbytura që qëndrojnë të tilla për disa muaj (zakonisht gjithë pranverën). Rreth 200 -300 ha qëndrojnë për pjesën më të madhe të vitit dhe specialistët sugjerojnë që kjo të konsiderohet si një habitat i mjediseve të lagësht, si një sipërfaqe me rëndësi të veçantë për biodiversitetin.

Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës

Popullsia

Popullsia e bashkisë Maliq vlerësohet në një marrëdhënie intensive me natyrën. Ndërsa tradicionalisht punojnë kryesisht tokën bujqësore, ka një ndërhyrje më të ashpër me pyjet për sigurimin e druve të zjarrit. Kjo është më e evidente në zonën kodrinore-malore të kësaj bashkie, specifikisht në Njësinë Administrative Lozhan dhe Moglicë, ku banorët dhe disa subjekte private, ndërhyjnë abuzivisht në pyje për prodhim drush zjarri. Në qytet zhvillohen edhe disa aktivitete ekonomike si tregëtia e shërbimet, industria e përpunimit të drurit (prodhim paletesh dhe peleti), kohët e fundit po zhvillohet industria ushqimore-sektori i përpunimit të peshkut e prodhimeve të tjera të detit, etj.

Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë

Drejtimit kryesore (degët kryesore) të zhvillimit

Në bashkinë Maliq aktualisht, krahas tregëtisë dhe shërbimeve zhvillohen edhe disa aktivitete industriale si industria e përpunimit të drurit, industria ushqimore e përpunimit të peshkut dhe prodhimeve të tjera të detit, industria energjetike HEC-i i Moglicës (janë në funksionim edhe disa HEC-e të vegjël malorë).

Projektet kryesore që planifikohet të zhvillohen

Disa prej projekteve kryesore që planifikohet të zhvillohen janë:

1. Promovim i kompleksit ekonomik agro-ushqimor me drejtim ekologjik, që zhvillohet në ish zonën industriale, pa funksion prej vitesh dhe burim ndotjeje.
2. Përmirësim i bonifikimit të fushës së Maliqit.
3. Krijim i qendrës së sporteve ujore në lumin e Devollit.
4. Krijimi i zonës së argëtimit buzë lumit Devoll, lidhje me Pyllin e Përzier të Maliqit.

Shqetësimi i biodiversitetit dhe i natyrës në tërësi prej realizimit të tyre

1. Sipas pikës 1 më sipër: Rivitalizohet zona dhe eliminohet një vatër ndotjeje.
2. Sipas pikës 2 më sipër: Do të ishte shumë pozitiv për biodiversitetin lënia e një sipërfaqeje toke si habitat i terreneve të lagësht, do të kryhej në këtë rast një vëllim më i vogël punimesh bonifikuese, do të shpenzoheshin çdo vit më pak lekë.
3. Sipas pikës 3 më sipër: Do të ketë një shqetësim të faunës ujore.
4. Sipas pikës 4 më sipër: Do të ketë një shqetësim të faunës ujore si pasojë e prezencës së shtuar të vizitorëve, pa përjashtuar rastin që mund të ushtrohet edhe peshkim i pakontrolluar.

Vlerësim real i vazhdimësisë apo anasjelltas, i fragmentarizimit të biokorridoreve.
Nuk do të ketë zhvillime infrastrukture që fragmentizojnë korridoret ekologjikë.

Bashkia Gramsh

Vlerat natyrore të territorit të bashkisë

Vlerat kryesore natyrore të bashkisë Gramsh janë:

1. Mali i Tomorrit
2. Lumi i Devollit
3. Kanionet e Sinecit dhe të Holtës
4. Liqenet e Valamarës
5. Ujëvara e Sotirës

Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale

Sistemet e përdorimit të tokës

Sipas standartizimit të përdorimit të territorit dhe burimeve natyrore, territori i bashkisë Gramsh ndahet në pesë sisteme përdorimi, ne përqindje, si vijon:

1. Sistemi natyror (pyje kullota, etj) 80.11 %
2. Sistemi ujqor 4.67 %
3. Sistemi bujqësor 13.76 %
4. Sistemi urban 0.82 %
5. Sistemi infrastrukturor 0.64 %

Menaxhimi i burimeve natyrore pyje, kullota, toka bujqësore, burime ujore, burime minerale

Menaxhimi i pyjeve

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore të fondit pyjor bashkiak:

TABLE 11. TË DHËNA MBI FONDIN PYJOR, BASHKIA GRAMSH

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia	Shënime
1	Sipërfaqja e përgjithshme	54 103 ha	
2	Tipet e grumbujve pyjorë	Pyje pishe të zezë, pyje dushqesh (shparth, qarr, bungëbutë, bulgër), pyje dushqesh me shkozë, dëllinja, etj.	
3	Raporti cungishte: trungishte	60: 40	
4	Raporti Pyje Fletorë: Halorë: Të përzier	11 205 ha: 4875 ha: 1380 ha	
5	Numri i ekonomive pyjore (sa kanë plan mbarështimi e sa nuk kanë)	13, 5 prej tyre kanë plan mbarështimi.	

6	Biodiversiteti në pyje (numur specimesh bimore, të dhëna për faunën, gjitarët e mëdhenj)	Bimësi barishtor rreth 28 lloje të evidentuar, dhjetra shkurre e më pak lloje drunorë. Gjitarët e mëdhenj janë prezent, edhe familjet e gjinitë e tjera të faunës. Ka rëndësi të theksohet se gjenden rreth 100 specie që i përkasin listës së specieve të rrezikuara sipas IUCN	Speciet e rrezikuara u perkasin kryesisht bimëve, insekteve dhe shpendëve.
7	Vlera natyrore të spikatura (shumë pak të tilla, çfarë u jep emër si krahinë)	Ka 21 monumente natyre. Fondi pyjor është i vendosur mbi një reliev shumë të larmishëm me amplitude të madhe në lartësi, duke mundësuar kështu të gjitha zonat fitoklimatike.	
8	Dy – tre shqetësimet aktuale kryesore në pyjet e bashkisë	Prerjet e paligjshme në pyje që ka çuar deri në degradim disa sipërfaqe pyjore, Prekja nga semundjet (procecionarja, etj.). Cektësimi i tokës pyjore prej erozionit sipërfaqësor të zhvilluar.	
9	Veprimet (ndërhyrjet) menaxhuese aktuale në pyjet e bashkisë	Planifikim masash përmirësuese, pyllëzime, sistemime malore, prerje sanitare.	

Mungon shfrytëzimi i pyjeve si aktiviteti kryesor silvikulturor pasi deri në vitin 2026 është në fuqi Ligji i Moratoriumit në Pyje. Por nga ana tjetër, çdo vit ndërhyhet kryesisht në pyjet cungishte me prerje për prodhimin e druve të zjarrit, popullsia fshatare i prodhon vetë. Riveshja me bimësi e terreneve të eroduar si emergjencë, rekomandohet të bëhet me pyllëzime me formula të përziera (idealja 35-40 % halorë 60-65% fletorë) me pjesëmarrje të detyruar të llojeve drunorë e shkurreve të atyre llojeve që me sistemin e tyre rrënjor lidhin token dhe e mbrojnë atë prej erozionit (si robinia, hipofaja, etj.).

Menaxhimi i kullotave

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore për kullotat bashkiake

TABLE 12. TË DHËNA MBI FONDIN KULLOSOR, BASHKIA GRAMSH

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia	Shënime
1	Sipërfaqja e përgjithshme	10 074.64 ha	
2	Struktura (kullota verore, livadhe etj)	8320 ha kullota verore, 1754.64 ha kullota dimërore	
3	Sipërfaqja aktuale që kullotet, numri i bagëtive që kullosin në një sezon	4 320 ha	
4	Kullotja: E moderuar, Mbikullotet, Nuk kullotet	Ka edhe mbikullotje në sipërfaqen që kullotet, Rreth	Situata aktuale e kullotave paraqet kapacitet jo të kënaqshëm, ka shumë

		50% e kullotave verore nuk kulloten.	sipërfaqe kullotash me bimësi të pakët barishtore, ka shumë gurë të lire në to.
5	A përbën shqetësim fauna e egër për bagëtinë	Nuk përbëjnë, janë prezent ujku, ariu, dhelpra, etj., por ka qënë në zvogëlim numri i tyre.	

Aktiviteti i kullotjes së bagëtive zhvillohet intensivisht në kullotat dimërore dhe në pyjet cungishte e shkurrishet. Duke mos patur kullotje të kontrolluar, rotacion të rregullt të sipërfaqeve që kulloten, dhe kullotje në çdo periudhë, ky fond pyjor dhe kullor dëmtohet në mënyrë frekvente prej këtij aktiviteti.

Menaxhimi i tokës bujqësore

Toka bujqësore në bashkinë Gramsh është relativisht e pakët (13.76% e territorit). Ka rreth 670ha në zonat kodrinore-malore që është pa përdorim. PPV jo vetëm parashikon investime por edhe jep rekomandime. Me rëndësi për këtë sektor theksohet kultivimi i gjithë fondit të tokës (theksojme këtu që fondi i tokës bujqësore parashikohet të zvogëlohet me rreth 50 ha për ndërtim godinash dhe infrastrukturë). Për tokat e pjerrta (kodrinore) një sugjerim me shumë rëndësi është kultivimi i tyre me foragjere ose me kultura pyjore, për mbrojtjen e tyre nga erozioni. Një zhvillim i tillë kërkon mbështetje për fermerët prej bashkisë. Duke qënë toka bujqësore shumë e copëzuar në aspektin e pronësisë, sugjerohet krijimi i fermave nëpërmjet zhvillimit të tregut të tokës ose shoqërizimit të punës e mjeteve kapitale. Në mbështetje të zhvillimit të bujqësisë në Plan paashikohen investime strategjike si ngritja në Gramsh e një qendre të grumbullimit e tregë timit të produkteve bujqësore e blegtorale, zhvillim i ri cilësor i industrisë ushqimore, rehabilitim i përgjithshëm i sistemeve ujitës e kullues, masa mbrojtëse të tokës bujqësore prej tre rreziqeve reale, përmbytjeve, gërryerjes së brigjeve të lumenjve, erozionit sipërfaqësor të tokave të pjerrta.

Menaxhimi i burimeve ujore

Burimet ujore të bashkisë Gramsh përfaqësohen prej lumit Devoll dhe 5 përenjve që e ushqejnë si Tomorrica, Grabova, Holta, etj., katër liqene si ai i Banjës (i krijuar si element i HEC-it me të njëjtin emër), liqeni i zi, liqeni i Bratillës dhe ai i Dushkut. Burimet ujore të bashkisë përdoren shumë për prodhim të energjisë elektrike prej ujit. Për rjedhojë, si në rjedhën e tyre gjatësore, ashtu edhe në liqenet/rezervuarët e krijuar në veprat e marrjes, makrosistemi ujur ka pësuar modifikime madhore prej ndërhyrjes së njeriut. Është favorizuar erozioni dhe rëshqitjet prej punimeve të gërmimeve, janë dëmtuar ndjeshëm habitatet e lagësht në brigjet e tyre. Prandaj Plani parashikon punime për sistemim të brigjeve, frenim të erozionit, riinstalim të bimësisë në faqet e tyre.

Një aspekt tjetër i menaxhimit të burimeve ujore është përdorimi i tyre për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm. Janë planifikuar ndërtime ujësjellsash në 9 fshatra. Një projekt interesant, është ai që propozohet për grumbullimin e ndarë të ujrave të bardha (uji i reshjeve) prej atyre të ndotura në qytetin e Gramshit.

Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës

Popullsia

Popullsia e bashkisë Gramsh është relativisht e vogël, prej rreth 35000 banorësh. Mbizotëron mjedisi rural, ka 9 njesi administrative. Në qytet ngelet sfidë menaxhimi i integruar i mbetjeve sikundër është grumbullimi i ndarë i mbetjeve të riciklueshme në burim, pra në shtëpi, hedhja e mbetjeve në vende të

paautorizuara, mungesa e kompostimit të mbetjeve organike në kopshtin e shtëpisë, etj. Në fshatra shqetësuese janë ndërhyrjet masive në pyje për sigurimin e druve të zjarrit. Miniprojektet në bazë fshati të përgatitur nga personeli pyjor i bashkisë, në shumë raste nuk respektohen. Kullotja në kullotat natyrore dhe në pyje bëhet e paorganizuar.

Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë

Drejtimet kryesore (degët kryesore) të zhvillimit

Në bashkinë Gramsh industria ka njohur zhvillime të një rëndësie kombëtare si ajo e demontimit të armëve, fabrika e prodhimit të baterive. Industria tradicionale si ajo agroushqimore parashikohet të ketë zhvillim cilësor. Industria energjetike me HEC-in e Banjës mbi lumen Devoll, janë në funksion dhe planifikohen disa HEC-e lokale mbi lumen e Tomorricës dhe atë të Holtës, parashikohet ngritja e një parku fotovoltai. PPV parashikon edhe zhvillim të industrisë tekstile dhe asaj të prodhimit të këpucëve.

Projektet kryesore që planifikohet të zhvillohen

Disa prej projekteve kryesore që planifikohet të zhvillohen, me ndikime të mundshme, janë:

1. Ndërtim, përmirësim i një rrjeti linear rrugor që lidh 9 njësitë administrative të bashkisë, -duke kaluar edhe në shumë fshatra, -me qendrën, qytetin e Gramshit.
2. Mirëmbajtje e përmirësim i rrugëve ndërqytetëse që lidhin Gramshin me Belshin dhe me Divjakën.
3. Punime rehabilituese në sistemet kullues e ujitës në nivel bashkie. Ky projekt planifikon punime në sistemin e kanaleve kullues, atyre ujitës si edhe punime në rezervuarët për ujitje. Bëhet fjalë për largimin e mbetjeve të gurta e argjile të depozituara gjatë kohës në fundin e rezervuarit, gjë që zvogëlon ndjeshëm kapacitetin ujëmbajtës të tyre, pra edhe ul ndjeshëm efektivitetin e tyre. Për këtë arsye, pas një periudhe disavjeçare lind nevoja e largimit të këtyre materialeve nga fundi i rezervuarit.
4. Ndërtim i 10 HEC-eve lokalë mbi përroin e Tomorricës dhe atë të Holtës e ndonjë tjetri.
5. Ndërtime përforcuese e mbrojtëse prej gërryerjeve përgjatë lumit Devoll si edhe rreth liqenit të Banjës, të shoqëruara me krijimin e një shëtitoreje të gjatë.
6. Shpallja e dy parqeve rajonale si qendra rekreacioni por njëkohësisht edhe si zona të mbrojtjes së natyrës.

Shqetësimi i biodiversitetit dhe i natyrës në tërësi prej realizimit të tyre

1. Sipas pikës 1 më sipër: Në fazën e kryerjes së punimeve do të jetë një ndërhyrje e ndjeshme dhe do të paraqesë shqetësim për faunën, do të ketë edhe ndërhyrje me ndryshim përdorimi të territorit në fondin pyjor.
2. Sipas pikës 2 më sipër: Punimet zhvillohen mbi gjurmë ekzistuese, pra nuk ka fragmentarizim të ri dhe shqetësime të rinj.
3. Sipas pikës 3 më sipër: Punimet në rezervuarët janë më voluminoze dhe pengojnë përkohësisht edhe ujëpirjen. Okupohen sipërfaqe nga fondi pyjor me materialet inerte që nxirren prej shtretërve të tyre.
4. Sipas pikës 4 më sipër: HEC-et janë problematikë nga mënyra si operohet deri sot. Aksidentojnë sipërfaqe shumë më të mëdha se çfarë tregojnë projektet teknike, shpesh, në mënyrë të paligjshme mbledhin në kanalet e tyre ujra nga burime të ndryshme, duke varfëruar zona të madhësive të ndryshme nga rezervat ujore, kur uji për në veprën e marrjes kalon në tubacion apo në kanal, thahen segmente të konsiderueshme të rjedhjeve natyrore sipërfaqësore, përrenj apo lumenj. Pra një pjesë e mikrobasenit rreth tyre thahet, tjetërsohet rrezikohet jeta e qindra specieve bimore dhe të faunës, tokësore dhe ujore.

5. Sipas pikës 5 më sipër: Impakti negativ supozohet për sa kohë përdoren si masa mbrojtëse punime me beton të cilat denatyrojnë gjithë mjedisin e afërt dhe jo ndërhyrje të inxhinierisë biologjike.
6. Sipas pikës 6 më sipër: Ka ndikime pozitive në biodiversitet.

Vlerësim real i vazhdimësisë apo anasjelltas, i fragmentarizimit të biokorridoreve.

Nuk do të ketë zhvillime infrastrukturore që fragmentizojnë korridoret biologjike, por shqetësime të përkohshme në ta.

Bashkia Pogradec

Vlerat natyrore të territorit të bashkisë

Vlerat kryesore natyrore të bashkisë Pogradec janë:

1. Liqeni i Ohrit.
2. Kompleksi ujqor i Drilonit.
3. Pyjet e gështenjës, si kurorë e gjelbër e qytetit
4. Peizazhi i mbrojtur 'Guri i Nikës – Valamarë'
5. Monumentet e shumtë të natyrës, (rreth 17 të tillë) mes tyre Kanioni i Llëngës, Guri i Kamjes, Liqenet e Lukovës, etj.
6. Masivet pyjorë të Mokrës, Bishnica e Qafë Panja
7. Burimet e Tushemishtit
8. Gadishulli i Linit, gjeomonument

Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale

Sistemet e përdorimit të tokës

Sipas standartizimit të përdorimit të territorit dhe burimeve natyrore, territori i bashkisë Pogradec ndahet në pesë sisteme përdorimi, ne përqindje, si vijon:

1. Sistemi natyror (pyje kullota, etj) 86. %
2. Sistemi ujqor 0.7 %
3. Sistemi bujqësor 12.03 %
4. Sistemi urban 1.6 %
5. Sistemi infrastrukturor 0.4 %

Menaxhimi i burimeve natyrore pyje, kullota, toka bujqësore, burime ujore, burime minerale

Menaxhimi i pyjeve

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore të fondit pyjor bashkiak:

TABLE 13. TË DHËNA MBI FONDIN PYJOR, BASHKIA POGRADEC

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia	Shënime
1	Sipërfaqja e përgjithshme	22 105 ha	
2	Tipet e grumbujve pyjorë	Pyje ahu; Pyje dushqesh (qarr, shparth, etj.); Pyje artificiale	

		(pyllëzime) pishe të zezë dhe pyje natyralë pishe të zezë	
3	Raporti cungishte: trungishte	66: 34	
4	Raporti Pyje Fletorë: Halorë: Të përzier	98: 0.33: 1.67	
5	Numri i ekonomive pyjore (sa kanë plan mbarështimi e sa nuk kanë)	Ka 14 ekonomi pyjore, 4 me Plan Mbarështimi, 10 nuk kanë.	
6	Biodiversiteti në pyje (numur specimesh bimore, të dhëna për faunën, gjitarët e mëdhenj)	Nga bimësia drunore veçohet arneni, nga fauna veçohet ariu dhe gjeli i egër.	
7	Vlera natyrore të spikatura (shumë pak të tilla, çfarë u jep emër si krahinë)	Pyjet e ahut të Bishnicës.	
8	Dy – tre shqetësimet aktuale kryesore në pyjet e bashkisë	Mungesa e specialistëve profesionistë; Mungesa e trajtimeve silvikulturore sipas fazave të zhvillimit të grumbujve pyjorë; Prerje të paligjshme në pyje; Aktivitete minerare; Mungesa e pyllëzimeve; Mungesa e planeve të mbarështimit për çdo ekonomi pyjore.	Trajtimet silvikulturore mund të bëhen, sepse ndërhyrjet në pyjet e dushkut bëhen çdo vit nga fshatarësia për prodhimin e druve të zjarrit.
9	Veprimet (ndërhyrjet) menaxhuese aktuale në pyjet e bashkisë	Prerje kulturore, ekoomia pyjore Bishnicë, pjesa ekonomike Uji i ftohtë	Ndërhyrjet bëhen në trungishtet e ahut, pyje gati 40-45 vjeçarë.

Mungon shfrytëzimi i pyjeve si aktiviteti kryesor silvikulturor pasi deri në vitin 2026 është në fuqi Ligji i Moratoriumit në Pyje. Por nga ana tjetër, çdo vit ndërhyhet kryesisht në pyjet cungishte me prerje për prodhimin e druve të zjarrit, popullsia fshatare i prodhon vetë. Hartohen miniprojekte punimesh përmirësuese por nuk kontrollohen dot të gjitha prej personelit pyjor dhe shpesh këto punime përmirësuese kthehen në përkeqësuese. Gjithashtu në pyjet e ahut, në ekonominë pyjore Bishnicë, kryhen prerje kulturore në një numur të vogël parcelash, për të siguruar drutë e zjarrit për institucionet publike, kopshte, shkolla, etj, kryesisht për qytetin e Pogradecit. Këto punime bashkia i kontraktonte me subjekte private. Shqetësimi është se këta subjekte nuk respektojnë plotësisht teknikën e ndërhyrjes që përcakton projekti i bashkisë, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor dhe, për këtë shpesh, personeli pyjor gjatë kontrollit të punimeve i bllokoi, ose i penalizoi subjektet kur konstatoi shkelje.

Menaxhimi i kullotave

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore për kullotat bashkiake

TABLE 14. TË DHËNA MBI FONDIN KULLOSOR, BASHKIA POGRADEC

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia	Shënime
1	Sipërfaqja e përgjithshme	3864 ha	

2	Struktura (kullota verore, livadhe etj)	Kullota verore	Natyrisht që përdoren edhe kullotat dimërore dhe pyjet e dushqeve dhe shkurret.
3	Sipërfaqja aktuale që kullohet, numri i bagëtive që kullosin në një sezon	545,4 ha, 900 krerë dele dhe 151 lopë.	1512 ha të shfrytëzuar në vitet e fundit
4	Kullotja: E moderuar, Mbikullotet, Nuk kullohet		
5	A përbën shqetësim fauna e egër për bagëtinë	Nuk ka të dhëna për dëme.	

Aktiviteti i kullotjes së bagëtive zhvillohet intensivisht në kullotat dimërore dhe në pyjet cungishte e shkurret. Kjo nuk pasqyrohet më lart pasi nuk u dha informacion nga personeli pyjor i bashkisë. Duke mos patur kullotje të kontrolluar, rotacion të rregullt të sipërfaqeve që kullohen, kullotje në çdo periudhë, ky fond pyjor dhe kullosor dëmtohet në mënyrë frekvente prej këtij aktiviteti.

Menaxhimi i tokës bujqësore

Toka bujqësore në bashkinë Pogradec, në Njësinë Administrative Buçimas, në fshatrat Starovë dhe Tushemisht, ka devijuar në një shkallë shqetësuese nga funksioni i vet kryesor, ai prodhues i produkteve bujqësore, sepse ka pasur shumë ndërtime si për banesa ashtu edhe për struktura akomoduese dhe shërbimesh për turistët. Për rjedhje, është zvogëluar sipërfaqja e tokës bujqësore të kultivuar, është fragmentizuar dhe ishulluar kontigjenti i tokave bujqësore. Një shqetësim tjetër madhor për sektorin e bujqësisë ka qënë mosmirëmbajtja, braktisja, nxjerrja jashtë funksioni e një pjese të mire të sistemit ujitës dhe atij të kullimit të tokave bujqësore të bashkisë. Por megjithatë, bujqësia zhvillohet tradicionalisht. Kultivimi i rrushit dhe prodhimi i verës janë një vlerë cilësore e kësaj bashkie. Frutikultura ka rritur gjithashtu peshën e saj.

Menaxhimi i burimeve ujore

Liçeni i Ohrit është pasuria ujore kryesore e bashkisë dhe një nga më të rëndësishmet e vendit. Duke qënë pjesë e zonës së mbrojtur 'Peizazhi i mbrojtur ujor-tokësor i Pogradecit', ai, krahas përdorimit si plazh dhe shërbimesh të tjera turistike, monitorohet e menaxhohet si një vlerë e jashtëzakonshme natyrore, duke qënë elementi më i rëndësishëm i sitit të UNESCO-s me të njëjtin emër (Siti i Ohrit). Burimet e tjera ujore me rëndësi janë disa përenj që derdhen në liçen dhe ndikojnë në cilësinë dhe sasinë e ujit të tij. Të tillë janë lumi i Çëravës, peroi i Vërdovës, etj. Mosderdhja e mbetjeve familjare dhe ujrave të ndotura në këta burime ujore përbën aspektin kryesor të përkujdesjes së tyre. Në zonën e Mokrës, në Gurin e Nikës, rjedh (me burim nga Valamara) një degë fillestare e lumit të Shkumbinit. Ndërtimi në rjedhën e tij i 5-6 HEC-eve, ka sjellë dëmtime të shumta në shtrat, deri edhe denatyrim të tij në segmente të caktuar (sidomos dy HEC-et në kuotat e ulta, pranë fshatit Slabinjë).

Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës

Popullsia e bashkisë Pogradec shkon rreth 80-90 000 banorë, gjysma banorë në qytet (Pogradec) dhe gjysma tjetër në 7 njësi administrative (Çëravë, Dardhas, Buçimas, Udënisht, Trebinjë, Proptisht e Velçan). Edhe sjellja e komunitetit ndaj natyrës e burimeve natyrore ka dy aspekte, një përdorim intensiv i liçenit në sezonin veror dhe një përdorim i konsiderueshëm i burimeve natyrore, kryesisht i pyjeve, në zonat e

thella të bashkisë (Mokra). Këta përdorime përcaktojnë edhe një shqetësim të konsiderueshëm të natyrës dhe në veçanti të biodiversitetit në ekosistemin pyll dhe në ekosistemin ujqor të liqenit.

Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë, me fokus: Drejtimet kryesore (degët kryesore) të zhvillimit

Plani i Përgjithshëm Vendor përcakton si drejtim kryesor të zhvillimit të bashkisë turizmin shumëplanësh, natyror, kulturor, rekreativ, kulinar, historik. Industria minerare, me shumë vlerë në të shkuarën, në këtë plan parashikohet të zvogëlohet ndjeshëm. Bujqësia do të ketë një zhvillim cilësor pasi do të mbështetet me shumë projekte, si për shtimin e prodhimit ashtu edhe për magazinimin, ruajtjen dhe përpunimin industrial të produkteve të saj. Blegtoaria gjithashtu do të ndihmohet në zonën e Mokrës.

Peshkimi është një aktivitet ekonomik që do të zhvillohet nën kontroll të fortë, duke u vlerësuar edhe si një mjet menaxhues i faunës së ujit.

Projektet kryesore që planifikohet të zhvillohen

Projektet që planifikon PPV i bashkisë Pogradec janë të shumtë. Kështu që në vijim paraqiten të grupuar, në fushat që lidhen direkt me shqetësimet në biodiversitet:

1. Është në vazhdim ndërtimi i rrugës nacionale Qukës - Qafë - Pllaçë.
2. Planifikohet ndërtimi i një rrjeti të pasur rrugësh rurale, krahas atyre ekzistuese (si akse kryesore që lidhin njësitë administrative me qytetin) që lidhin fshatrat midis tyre duke përshkuar kështu edhe tokat bujqësore.
3. Planifikohet ndërtimi i ujësjellsave të rinj në fshatra, ku depot dhe rrjeti kryesor depo – fshat, shkaktojnë ndërhyrje të ndjeshme në natyrë, në terrenin kodrinor-malor.
4. Planifikohen ndërhyrje të përgjithshme në sistemet ujitës e kullues të tokave bujqësore.

Shqetësimi i biodiversitetit dhe i natyrës në tërësi prej realizimit të tyre

1. Për sa i përket pikës 1 më sipër: Duke u zhvilluar në pjesën më të madhe të tij në zonën malore, pyjore të Mokrës, ky projekt, si tani në fazën e ndërtimit ashtu edhe në fazën e frekuentimit të tij, përbën një shqetësim të konsiderueshëm në biodiversitet, tek gjitarët e mëdhenj. Gjithashtu ky aks rrugor përbën edhe ndërprerje të korridorit përkatës ekologjik, fragmentarizim të tij.
2. Për sa i përket pikës 2 më sipër: Shumë rrugë do të kalojnë në terren pyjor dhe si në fazën ndërtimore ashtu edhe atë funksionale do të përbëjnë shqetësim për gjitarët e mëdhenj.
3. Për sa i përket pikës 3 më sipër: Do të jetë i njëjti shqetësim në fazën e ndërtimit të tyre. Nga ana tjetër krijohet edhe një vështirësi për disponueshmërinë e ujit për kafshët e egra.
4. Ndërtimi i rezervuarëve të rinj për ujitje do të ketë ndikim të dyanshëm, ndërtimi i tyre do të përbëjë shqetësim, në vazhdimësi, por nga ana tjetër krijohet një ekosistem i ri ujqor dhe një mundësi për disponueshmërinë e ujit për faunën.

Vlerësim real i vazhdimësisë apo anasjelltas, i fragmentarizimit të biokorridoreve.

Një ndërprerje korridori me ndikim të konsiderueshëm shkakton ndërtimi dhe më pas funksionimi i aksit nacional rrugor Qukës – Qafë Pllaçë, i cili zhvillohet në një zonë të thellë, larg zonave urbane, në terren kodrinor – malor dhe në lugina që kalojnë pranë ose përmes pyjeve.

Bashkia Prrenjas

Vlerat natyrore të territorit të bashkisë

Vlerat kryesore natyrore të bashkisë Prrenjas janë:

1. Parku Kombëtar 'Shebenik – Jabllanicë'
2. Pylli i ahut i Rajcës, sit i UNESCO-s, Pasuri e Trashëgimisë Natyrore Botërore
3. Parku Natyror 'Stravaj-Sopot'
4. Pyjet e ahut të ekonomisë pyjore Stravaj

Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale

Sistemet e përdorimit të tokës

Sipas standartizimit të përdorimit të territorit dhe burimeve natyrore, territori i bashkisë Prrenjas ndahet në pesë sisteme përdorimi, ne përquindje, si vijon:

1. Sistemi natyror (pyje kullota, etj) 72.7 %
2. Sistemi ujqor 0.4 %
3. Sistemi bujqësor 24.74 %
4. Sistemi urban 2.5 %
5. Sistemi infrastrukturor 0.5 %

Menaxhimi i burimeve natyrore pyje, kullota, toka bujqësore, burime ujore, burime minerale

Menaxhimi i pyjeve

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore të fondit pyjor bashkiak:

TABLE 15. TË DHËNA MBI FONDIN PYJOR, BASHKIA PRRENJAS

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia
1	Sipërfaqja e përgjithshme	15 794 ha
2	Tipet e grumbujve pyjorë	Pishë e zezë, bredh, halorë të tjerë, ah, plep, dushqe, shkozë, etj.
3	Raporti cungishte: trungishte: shkurre	27: 48; 25
4	Raporti Pyje Fletorë: Halorë: Të përzier	92: 2: 6
5	Numri i ekonomive pyjore (sa kanë plan mbarështimi e sa nuk kanë)	7 ekonomi pyjore, 2 ekonomi kullosore. Kanë Plan Mbareshtimi 2 ek. pyjore dhe 1 ek. kullosore.
6	Biodiversiteti në pyje (numur specimesh bimore, të dhëna për faunën, gjitarët e mëdhenj)	Me shumicë gjitarët e mëdhenj (arinj më shumë se dy, ujqërit me kope).
7	Vlera natyrore të spikatura (shumë pak të tilla, çfarë u jep emër si krahinë)	'Mali plak' për nga vjetërsia
8	Dy – tre shqetësimet aktuale kryesore në pyjet e bashkisë	Prerjet e paligjshme
9	Veprimet (ndërhyrjet) menaxhuese aktuale në pyjet e bashkisë	Përgatitje e një Pl. Mb., riparim lere, sistemime malore, prerje kulturore.

Mungon shfrytëzimi i pyjeve si aktiviteti kryesor silvikulturor pasi deri në vitin 2026 është në fuqi Ligji i Moratoriumit në Pyje. Por nga ana tjetër, çdo vit ndërhyhet kryesisht në pyjet cungishte me prerje për prodhimin e druve të zjarrit, popullsia fshatare i prodhon vetë. Hartohen miniprojekte punimesh përmirësuese por nuk kontrollohen dot të gjitha prej personelit pyjor dhe shpesh këto punime përmirësuese kthehen në përkeqësuese.

Menaxhimi i kullotave

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore për kullotat bashkiake

TABLE 16.TË DHËNA MBI FONDIN KULLOSOR, BASHKIA PRRENJAS

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia	Shënime
1	Sipërfaqja e përgjithshme	1841.32 ha	
2	Struktura (kullota verore, livadhe etj)	Verore	
3	Sipërfaqja aktuale që kullohet, numri i bagëtive që kullosin në një sezon	256.55 ha, kullosin 611 krerë	Kapacitet i papërdorur rreth 85 %.
4	Kullotja: E moderuar, Mbikullotet, Nuk kullohet	E moderuar	Ndofta mund të cilësohet racionale, sepse kullosin mesatarisht 2.5 krerë / ha.
5	A përbën shqetësim fauna e egër për bagëtinë	Kopetë e ujqërve dhe arinjte	

Aktiviteti i kullotjes në kullotat verore joekzistent në 85% të sipërfaqes. Blegtoaria sektor me resurse natyrore të konsiderueshme. Duke mos patur kullotje të kontrolluar, rotacion të rregullt të sipërfaqeve që kullohen dhe kullotje në çdo periudhë, ky fond pyjor dhe kulloros dëmtohet në mënyrë frekvente prej këtij aktiviteti.

Menaxhimi i tokës bujqësore

Bujqësia në bashkinë Prrenjas zhvillohet në 8660 ha. Vlen të theksohet se vetëm rreth 13 % e këtij fondi është tokë e bonitetit I-IV. Nisur nga ky realitet një vëmendje e veçantë i kushtohet kufizimit të ndërtimeve dhe sidomos përdorimit me efektivitet të ndërtimeve ekzistuese që i shërbejnë direkt sektorit të bujqësisë, rehabilitimit të tyre ku është e nevojshme. Natyrisht kushtohet vëmendje edhe për tokat bujqësore të vendosura në terrenet kodrinore, aktualisht masivisht të papërdorura. Për to duhet të ofrohen insentiva që fermerët të interesohen t'i kultivojnë ato me bimësinë e përshtatshme.

Menaxhimi i burimeve ujore

Bashkia Prrenjas ka rreth 25 km rrjet hidrik me rjedhje sipërfaqësore, të përfaqësuar kryesisht prej dy lumenjve Shkumbin dhe Devoll dhe një sërë përrenjsh në njësitë administrative të Stravajt dhe të Rajcës. Gjenden edhe disa liqene të vegjël natyralë dhe një numur rezervuarësh për ujitje. Ka një fond ujor nëntokësor shumë të pasur dhe cilësor për shkak të sipërfaqes së konsiderueshme pyjore bashkiake dhe fondin pyjor të zonave të mbrojtura. Vlerësim dhe vëmendje kryesore i kushtohet shtretërve dhe brigjeve të dy lumenjve kryesorë. Dy janë aktivitetet strategjike për ta :1. Rinatyalizimi i shtretërve e brigjeve të tyre në segmentet e dëmtuar prej ndërhyrjeve ilegale apo prej ndërhyrjeve të mëparshme mbrojtëse me punime betoni; 2. Rivitalizimi i zgjerimeve në shtrat të lumit, duke tentuar kthimin e tyre në sipërfaqe të terreneve të lagësht, që kanë një rol të vyer në mbajtjen e ujit në rast prurjesh të mëdha në rast reshiesh të vullshme e të bollshme, që ndihmojnë në shmangien e përmytjeve.

Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës Popullsia

Popullsia e bashkisë Prrenjas shkon rreth 32000-33000 banorë. Është e shpërndarë në qytetin e Prrenjasit dhe në tre njësitë administrative Rajcë, Qukës dhe Stravaj. Karkarakteristik është fakti që vetëm rreth 9500 banorë jetojnë në qytetin e Prrenjasit. Pjesa më e madhe jeton në fshat. Duke pasur një aktivitet minerar, në mënyrë të pashmangshme dëmtohet peizazhi. Pra dëmtimi minimal, duke punuar në sipërfaqe të vogla dhe duke i rehabilituar më pas ato, përbën sfidën e vërtetë të minatorëve e personelit inxhiniero-teknik. Në zonat rurale dy janë ndërhyrjet që janë problematike, së pari ndërhyrjet në pyje për prerjen e lëndës drusore dhe këtu, për këtë bashki ka dy aktorë të rëndësishëm-popullsia dhe subjektet private-; së dyti, ndërhyrjet në shtretërit e lumenjve e përrenjve për HEC-e lokale. Në ndërhyrjen e dytë problematika është e mprehtë pasi janë tharë segmente të gjatë edhe mbi 1km (rasti mbi Shkumbin, në veri të qytetit të Prrenjësit, anës rrugës nacionale).

Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë, me fokus: Drejtimit kryesore (degët kryesore) të zhvillimit

Plani i Përgjithshëm Vendor përcakton këto drejtime kryesore të zhvillimit ekonomik për bashkinë Prrenjas:

- Industria minerare do të konsistojë vetëm në nxjerrjen e mineralit të nikelit e të kromit, bazuar në konkurrueshmërinë dhe zgjidhjet e përshtatshme teknologjike.
- Planifikohet prodhimi i ujit të pijshëm të fabrikuar në Rajcë. Industria agrourbore do të njohë zhvillim cilësor. Turizmi, veçanërisht ai i bazuar tek natyra (ekoturizmi), dhe bujqësia do të vazhdojnë të jenë degë të rëndësishme të ekonomisë.

Projektet kryesore që planifikohet të zhvillohen

Projektet që planifikon PPV i bashkisë Prrenjas.

1. Është në vazhdim ndërtimi i rrugës nacionale Qukës-Qafë – Pllaçë.
2. Rikualifikimi i zonës urbane të Prrenjasit dhe i qendrave të fshatrave.
3. Fuqizimi i sistemit prodhues agrourbore.
4. Planifikohet ndërtimi i ujësjellsave të rinj në fshatra.
5. Rikualifikim i sistemit rrugor në tre nivelet.

Shqetësimi i biodiversitetit dhe i natyrës në tërësi prej realizimit të tyre

1. Për sa i përket pikës 1 më sipër: Si rrugë e re që kalon kryesisht në territore rurale, në pyje dhe pranë tyre, shkakton shqetësime në biodiversitet, tani në fazën ndërtuese. Edhe kur të qarkullohet në të shqetësimet do të vazhdojnë. Fragmenton korridoret ekologjikë.
2. Për sa i përket pikës 2 më sipër: Nuk ka ndikim.
3. Për sa i përket pikës 3 më sipër: Zhvillohen ndërhyrje në zonën urbane dhe në fondin e tokës bujqësore. Kështu që shqetësimet janë të pakta.
4. Për sa i përket pikës 4 më sipër: Punimet në kuotat e larta, si grumbullim i ujit të burimeve, ndërtimi i depove, ndërtimi i linjave kryesore të tubacionit, shkaktojnë shqetësime në biodiversitet. Grumbullimi i ujit të burimeve sjell vështirësi për botën e gjallë, pasi pakësohen rjedhjet sipërfaqësore që shërbejnë për instalimin e zhvillimin e florës e ihtiofaunës, amfibëve, etj., vështirësohet pirja e ujit për faunën e egër.

5. Për sa i përket pikës 5 më sipër: Punimet për çelje segmentesh të rinj rrugorë, shkaktojnë shqetësime në biodiversitet si zhurma, zvogëlim i sipërfaqeve me bimësi natyrore, etj.

Vlerësim real i vazhdimësisë apo anasjelltas, i fragmentarizimit të biokorridoreve.

Një ndërprerje korridori me ndikim të konsiderueshëm shkakton ndërtimi dhe më pas funksionimi i aksit nacional rrugor Qukës – Qafë Plloçë (që nga Qukësi deri në kufi me bashkinë Pogradec), i cili zhvillohet në një zone të thellë, larg zonave urbane, në terren kodrionor – malor dhe në lugina që kalojnë pranë ose përmes pyjeve.

Bashkia Librazhd

Vlerat natyrore të territorit të bashkisë

Bashkia Librazhd karakterizohet nga një natyrë shumë e pasur, e mbuluar nga masive pyjore dhe kullota. Në vijim përmendim:

1. Parku Kombëtar ‘Shebenik – Jabllanicë’
2. Parku natyror Stravaj – Sopot
3. Lumenjtë Devoll dhe Shkumbin me luginat e tyre

Me vlerë për studimin është fakti që lugina e lumit Devoll përcaktohet në Plan si një korridor ekologjik i rëndësishëm dhe tërhiqet vëmendja për ruajtjen e natyrës në të dhe rinatyalizimin e pjesëve e segmenteve të dëmtuar.

Menaxhimi dhe përdorimi aktual i territorit dhe i burimeve natyrore që gjenden në të si pyjet, kullotat, toka bujqësore, burimet ujore, burimet minerale

Sistemet e përdorimit të tokës

Sipas standartizimit të përdorimit të territorit dhe burimeve natyrore, territori i bashkisë ndahet në pesë sisteme përdorimi, ne përqindje, si vijon:

1. Sistemi natyror (pyje kullota, etj) 71.8 %
2. Sistemi ujqor 0.9 %
3. Sistemi bujqësor 23.3 %
4. Sistemi urban 2.7 %
5. Sistemi infrastrukturor 1.3 %

Menaxhimi i burimeve natyrore pyje, kullota, toka bujqësore, burime ujore, burime minerale

MENAXHIMI I PYJEVE

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore të fondit pyjor bashkiak:

TABLE 17. TË DHËNA MBI FONDIN PYJOR, BASHKIA LIBRAZHD

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia	Shënime
1	Sipërfaqja e përgjithshme	25 089.75 ha	
2	Tipet e grumbujve pyjorë	Pyje të thjeshtë fletorë (ahu, dushqet, plepi-shelgu-vërriu), të thjeshtë halorë (Pisha e zezë, bredhi), pyje të përzier.	

3	Raporti cungishte: trungshte	8: 92	
4	Raporti Pyje Fletorë: Halorë: Të përzier	81.7: 6.2: 12.1	
5	Numri i ekonomive pyjore (sa kanë plan mbarështimi e sa nuk kanë)	15 ekonomi pyjore, 2 ekonomi kullimore. 7 ek. pyj. kanë plane mb.	
6	Biodiversiteti në pyje (numur specimesh bimorë, të dhëna për faunën, gjitarët e mëdhenj)	Rreth 750 specie, 13 gjitarë	
7	Vlera natyrore të spikatura (shumë pak të tilla, çfarë u jep emër si krahinë)	Pyjet e gështenjës Rinas – Ballgjin, masivet pyjore të ahut, masivi kullimor i Polisit.	
8	Dy – tre shqetësimet aktuale kryesore në pyjet e bashkisë	Mungesa e pl. të mb., mungesa e specialistëve inxhinierë pyjesh dhe teknikë pyjesh.	
9	Veprimet (ndërrhyrjet) menaxhuese aktuale në pyjet e bashkisë	Dhënie me qira e kullotave dhe pyjeve.	

Mungon shfrytëzimi i pyjeve si aktiviteti kryesor silvikulturor pasi deri në vitin 2026 është në fuqi Ligji i Moratoriumit në Pyje. Librazhdi, si bashki e pasur me pyje, realizon ndërrhyrje në shkallë të gjërë në pyje me prerje kulturore. Ka të pranishëm dy fenomene, kompanitë e kontraktuara nga bashkia presin më tepër se sa përcaktojnë projektet teknike, shtrihen më tepër se sipërfaqet e kontraktuara dhe, ka subjekte që presin ilegalisht. Mjafton të përmendet se këta subjekte mbulojnë në masën 80-85% nevojat për dru zjarri të qytetit të Korçës.

Menaxhimi i kullotave

Në tabelën në vijim jepen të dhënat kryesore për kullotat bashkiake

TABLE 18. TË DHËNA MBI FONDIN KULLIMOR, BASHKIA LIBRAZHDI

Nr.	Emërtimi i të dhënës	Sasia	Shënime
1	Sipërfaqja e përgjithshme	9430.76 ha	
2	Struktura (kullota verore, livadhe etj)	Kullota verore	Natyrisht që ka edhe kullota dimërore ku kullotet jashtë sezonit dimëror (?)
3	Sipërfaqja aktuale që kullotet, numri i bagëtive që kullojnë në një sezon	308 ha, kullojnë 1256 dele dhe 335 dhi.	Duhet bërë kullotja më ekstensive, pra për këtë numur bagëtish të jepet dyfishi i sipërfaqes, mbi 500 ha.
4	Kullotja: E moderuar, Mbikullotet, Nuk kullotet	E moderuar (?) (sipas informacionit që jep bashkia)	Duhet vlerësuar e mbikullotur, 5 krerë/1 ha.

5	A përbën shqetësim fauna e egër për bagëtinë	Ujqërit shkaktojnë dëme.	
---	--	--------------------------	--

Aktiviteti i kullotjes së bagëtive zhvillohet intensisvisht në kullotat dimërore dhe në pyjet cungishte e shkurrishtet. Duhet rritur sipërfaqja e kullotave që jepet nëpërmjet kontratave bashki-subjekt. Duke mos patur kullotje të kontrolluar, rotacion të rregullt të sipërfaqeve që kullohen, dhe kullotje në çdo periudhë, ky fond pyjor dhe kullosor dëmtohet në mënyrë frekvente prej këtij aktiviteti.

Menaxhimi i tokës bujqësore

Zhvillimi i bujqësisë në bashkinë Librazhd është në qendër të vëmendjes së pushtetit vendor dhe ka një trajtim mjaft cilësor në PPV. Një gjetje shumë interesante është krijimi i disa tipologjive të zhvillimit të këtij sektori. I. Në sipërfaqet e vogla pranë shtëpive sugjerohet vazhdimi i zhvillimit të bujqësisë tradicionale, kryesisht me bimë frutore dhe perime. II. Në hapësirën Librazhd- Lunik qendër mendohet zhvillimi më masiv bujqësor, me idenë e mbështetjes për zhvillimin e fermave. III. Zhvillimi i agroturizmit në zona të lëna pa zhvillim, duke adaptuar shtëpitë e vjetra në bujtina, etj, dhe zhvillimin e fermës rreth tyre, duke ruajtur peizazhin bujqësor të pandryshuar. Një drejtim tjetër i rëndësishëm në mbështetje të sektorit bujqësor planifikohet të jetë zhvillimi i agroindustrisë me teknologji bashkëkohore. Lidhur me sistemin e ujitjes së bimëve bujqësore, dy janë drejtimet më të rëndësishme: së pari të rritet shkalla e pastërtisë së ujit që mbërrin në kanalet kullues që më poshtë përdoren për ujitje, pasi ky ujë rezulton me ndotje dhe ul cilësinë e produkteve bujqësore dhe rrezikon shëndetin njerëzor; së dyti, të përdoret në mënyrë racionale uji për ujitje duke kalkuluar paraprakisht nevojat për ujë të çdo kulture të mbjellë në çdo ngastër/parcelë toke bujqësore dhe të çohet në të sasia e nevojshme e jo pa limit.

Menaxhimi i burimeve ujore

Menaxhimi i burimeve ujore në bashkinë Librazhd, fokusohet në radhë të parë në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të segmenteve të lumenjve Shkumbin dhe Devoll që përshkojnë territroin administrative të bashkisë. Masat kryesore menaxhuese janë:

1. Mbrojtja e brigjeve dhe e shtretërve të lumenjve nga ndërhyrjet e paligjshme;
2. Rinatyalizimin e pjesëve të dëmtuara nga ndërhyrje të mëparshme të paligjshme;
3. Rivitalizim të xhepave (habitata të terreneve të lagësht;
4. Eliminim i ndotjeve prej shkarkimeve të ujrave të zeza dhe mbetjeve të ngurta familjare.

Një vëmendje e madhe u kushtohet gjithashtu liqeneve të vegjël natyrorë dhe rezervuarëve ujitës. Me shumë vëmendje konsiderohet dhe kujdesi për burimet e shumta të ujit që del nga nëntoka, për mirëmbajtje të tyre, mosbllokim të tyre, sigurim i rjedhjes së lire të ujit të tyre, mbajtjen pastër të tyre. Kjo sepse konsiderohen shumë të rëndësishëm për biodiversitetin në mikropellgje, për ujëpirje dhe për peizazh.

Sjellja e komunitetit dhe aktivitetet kryesore që zhvillon ai në territorin përkatës

Popullsia

Popullsia e bashkisë është e vendosur në qytetin e Librazhdit dhe 6 njësi administrative. Në vitin 2030 popullsia e bashkisë parashikohet të jetë rreth 48 000 banorë, rreth 11 000 në qytet (Librazhd) dhe rreth 37 000 në 6 njësitë administrative. Duke banuar $\frac{3}{4}$ e popullsisë në fshat, aktivitetet e popullsisë janë blegtorja: kujdesi dhe kullotja e bagëtive dhe prodhimi i produkteve blegtorale, bujqësia dhe ndërhyrjet

në pyje: prerja e materialit drunor për dru zjarri, prerja e gjethit si rezervë ushqimore dimërore për bagëtitë dhe kullotja e bagëtive në pyll. Këto ndërhyrje shkaktojnë shqetësime serioze për natyrën dhe biodiversitetin.

Studim dhe analizë e shkurtër e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë me fokus: Drejtimet kryesore (degët kryesore) të zhvillimit ekonomik

Drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik të bashkisë Librazhd sipas PPV dhe realitetit aktual, janë:

1. Zhvillimi i industrisë minerare si industri nxjerrëse, për nikelin dhe kromin.
2. Zhvillim i industrive të tjera në nivel artizanal.
3. Zhvillim i sektorit të shërbimeve si riparime, mirëmbajtje, rikonstruktive, etj.
4. Zhvillimi i turizmit të lehtë (kështu e përcakton Plani) duke ndërtuar një strategji turizmi bazuar tek natyra e pasur, kryesisht tek Parku Kombëtar 'Shebenik – Jabllanicë' pjesa e Stëblevës, me synimin të ngrihet këtu një model suksesi i turizmit në natyrë.

Projektet kryesore që planifikohet të zhvillohen në infrastrukturë, industri

1. Rikualifikimi i rrjetit rrugor midis qytetit dhe qendrave të njësive administrative, për të siguruar një transport komod dhe efektiv të njerëzve e mallrave.
2. Ngritja e një sistemi të menaxhimit të integruar të mbetjeve me destinacion final djegësin e Elbasanit.
3. Rikualifikimi i zonës urbane Librazhd.
4. Rikualifikimi i nënzonës prodhuese/artizanale.

Shqetësimi i biodiversitetit dhe i natyrës në tërësi prej realizimit të tyre

1. Për sa i përket pikës 1 më sipër: Sjell shqetësime në biodiversitet në fazën zhvilluese të projektit pasi në shumë segmente zhvillohet në territore rurale kodrinore, në terrene pyjore-livadhore.
2. Për sa i përket pikës 2 më sipër: Në nivel fshati, të paktën deri sot nuk ka ndonjë menaxhim, mbetjet familjare rëndom shkakrohen në proskat e përenjtë që kalojnë afër fshatit, duke ndotur ndjeshëm ekosistemin ujor në tërësi.
3. Për sa i përket pikës 3 më sipër: Nuk ka ndikim negativ pasi zhvillohet brenda qytetit dhe përfshin në vetvete edhe gjelbërimin që ka ndikim pozitiv.
4. Për sa i përket pikës 4 më sipër: I njëjti vlerësim si për pikën 3.

Vlerësim real i vazhdimësisë apo anasjelltas, i fragmentarizimit të biokorridoreve.

Ruhet vazhdimësia e korridoreve ekologjikë.

Mjedisi, aspekte kryesore të tij në zonën e studimit

Mjedisi, konsiderata dhe fokusi i këtij studimi mbi të

Situatat mjedisore në 6 bashkitë e zonës së studimit përgjithësisht janë të ngjashme, me ndryshime të pakta. Me rëndësi në këtë kapitull është përzgjedhja e problematikave kryesore mjedisore për çdo bashki dhe sidomos e atyre që lidhen me funksionin e zonës së studimit si rrjet ekologjik. Edhe zgjidhjet për këto problematika janë të përfshira në PPV-të përkatëse, respektivisht në Planin e veprimit në mjedis. Ajo çfarë synohet të paraqitet në këtë kapitull është listimi i problematikave më të mprehta, me ndikim në rrjetin ekologjik, me qëllim që të kryhen monitorime në vazhdimësi për shkallën e nivelin e eliminimit të tyre.

Tek zonat e mbrojtura në respekt të statusit të tyre, aspektet mjedisore janë në vëmendje kryesore të AdZM-ve përkatëse, ndiqen në mënyrë operative në vazhdimësi, tek to mbizotëron natyra, ku ruajtja e biodiversitetit përbën një ndër detyrat kryesore.

Për këto arsye, çështjet mjedisore më të mprehta, me ndikime në rjetin ekologjik, pra në gjithë zonën e studimit, nuk paraqiten në veçanti por listohen përgjithësisht, sipas elementëve përbërës të mjedisit. Nuk trajtohen në këtë kapitull çështjet e elementit mjedisor të lidhura me klimën, pasi trajtohet në kapitullin pasardhës.

Problematikat shqetësuese mjedisore që ndikojnë edhe në funksionin e zonës si rjet ekologjik.

Nr.	Situata mjedisore	Ku vërehet fenomeni
1	<p>Toka</p> <p>a. Toka bujqësore pëson fragmentarizim kryesisht prej projekteve të ndërtimit të segmenteve rrugorë të rjetit nacional, (si Çorovodë – Gramsh, Qukës – Qafë-Pllaçë). Edhe në ndërtimin e segmenteve rrugore rurale, ndodh fragmentizimi.</p> <p>b. Përdorimi i pesticideve, insekticideve, herbicideve, fungicideve etj., ndot tokën me elementë toksikë.</p> <p>c. Depozitimi i mbetjeve familjare direkt mbi tokë, (rëndom nëpër fshatra), e ndot atë.</p> <p>d. Erozioni i tokës në sipërfaqet e pjerrta të zhveshura.</p> <p>e. Okupimi i tokës bujqësore me ndërtim godinash, kryesisht banesash, (veçanërisht në nj.a. Hudënisht e Buçimas të bashkisë Pogradec) zvogëlon sipërfaqen e saj, e fragmentarizon atë, etj.</p> <p>f. Dampat e mineraleve, materialeve sterile, e ndotin tokën kryesisht me metale të rëndë.</p> <p>g. Cektësimi i tokave pyjore prej prerjeve abuzive të materialit drunor dhe erozionit sipërfaqësor që aktivizohet prej tyre, prishja e strukturës mekanike të tokës prej kalimit të mjeteve të rënda me lëndë drusore.</p>	<p>Bashkitë Skrapar, Gramsh, Prenjas, Pogradec</p> <p>Çdo bashki, më e theksuar në bashkinë Maliq, fusha e saj.</p> <p>Gjithë bashkitë, përveç bashkisë Maliq.</p> <p>Gjithë bashkitë</p> <p>Bashkia Pogradec</p> <p>Bashkia Pogradec</p> <p>Gjithë bashkitë, pyjet pranë fshatrave</p>
2	<p>Uji</p> <p>a. Shkarkimi direkt i ujrave të përdorura në përranj e lumenj sjell ndotjen e ujit sidomos me okside e kripra të azotit e fosforit. Mostrajtimi i tyre bën real rrezikun e epidemive.</p> <p>b. Dëmtimi masiv i pyjeve sjell çrregullim të qarkullimit të ujit në natyrë: reshie-krijim i vijave, rrëkeve, proskave, përranjve të vrullshëm, që derdhen në lumë. Uji ndotet prej erozionit në thellësi që ai vetë e shkakton dhe materialin e ngurtë që merr me vete.</p> <p>c. Devijimi i rjedhave natyrore të ujit prej veprave hidroteknike dhe grumbullimi i tyre në veprat e marrjes si edhe në rezervuaret ujitës,</p>	<p>Gjithë bashkitë, përjashtuar pjesërisht bashkia Pogradec</p> <p>Gjithë bashkitë, zonat e tyre malore.</p>

	<p>cënon parametrat e temperatures së tij dhe shpie kështu në ndotje bakteriologjike.</p> <p>d. Përdorimi i pesticideve ndot ujin, atë sipërfaqësor madje mbërrin shpesh deri në ujin nëntokësor.</p>	<p>Bashkitë Pogradec, Prrenjas.</p> <p>Bashkia Maliq</p>
3	Ajri	
	<p>a. Ndotjet e ajrit prej transportit rrugor në rritje.</p> <p>b. Ndotjet e ajrit prej aktiviteteve ndërtes, guroreve, minierave.</p> <p>c. Ndotja e ajrit në sezonin e dimrit prej djegies së druve të zjarrit për ngrohje (CO₂, CO, CmHn, Pm₁₀, Pm 2.5).</p> <p>d. Ndotjet e ajrit prej industrive të ndryshme.</p> <p>e. Ndotjet e ajrit prej bagëtive me NH₄, NOx.</p> <p>f. Ndotjet e ajrit me O₃ në shtresën e ulët të atmosferës, ku ai rezulton i dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe të bimëve, etj.</p> <p>g. Ndotjet e ajrit me hidrokarburet e florit e klorit, prej djegieve të mbetjeve, kryesisht atyre plastike, gazra shumë të rrezikshëm si për shkaktimin e efektit ‘Serrë’, ashtu edhe për dëmtimin e shtresës së ozonit në stratosferë.</p>	<p>Bashk. Gramsh, Skrapar, në rrugët rurale.</p> <p>Bashk. Skrapar, Pogr.</p> <p>Gjithë bashkitë.</p> <p>Gjithë bashkitë.</p> <p>Gjithë bashkitë.</p> <p>Bashkitë me menaxhim të keq të mbetjeve.</p>
4.	Biosfera dhe peizazhi	
	<p>a. Dëmtimet e mëdha në pyje sjellin edhe dëmtimet më të mëdha në biodiversitet, dëmtohet ekosistemi pyll, dëmtohen habitatet specifike të llojeve të shumta të faunës, rrezikohen për zhdukje speciet e rrezikuara. Vihet re regres në strukturën dhe formën e qeverisjes së pyjeve, shumë pyje ahu po kalojnë nga pyje të lartë (trungishte) në pyje të ulët (cungishte)</p> <p>b. Kultivimi në bujqësi i bimëve të modifikuara gjenetikiisht, sjell nga njëra anë zhdukjen graduale të kulturave bujqësore tradicionale, dëmton materialin gjenetik, nga ana tjetër rrezikon shëndetin e njerëzve prej konsumit të tyre.</p> <p>c. Habitate të caktuar të specieve të veçanta të rrezikuara (lloje bimore – barishtore, drunore, - lloje shpendësh, reptilësh, deri tek gjitarët) nuk kanë vëmendjen dhe mbrojtjen që meritojnë.</p> <p>d. Fauna në ekosistemet ujore të liqeneve e lumenjve dëmtohet prej ndotjeve të ujit nga shkarkimet e ujrave të ndotura (të përdorura), prej kimikateve që përdor bujqësia, etj).</p> <p>e. Guroret dhe aktivitetet minerare dëmtojnë rëndë peizazhin natyror dhe në to, nuk kryhen punime rehabilitimi. Ato shqetësojnë biodiversitetin edhe prej ndotjes akustike.</p> <p>f. Ndryshimet klimatike, rritja drastike e ndërhyrjeve humane në natyrë, rrezikojnë aktualisht zhdukjen e rreth 1 milion specieve në glob.</p> <p>g. Instalimi i llojeve invazivë përbën një rrezik të shtuar për biodiversitetin (bimë të larta si Arra e Hindit, disa lloje peshqish invazivë në liqene, etj.).</p> <p>h. Ndotjet në mjedis, ndryshimet klimatike kanë shtuar ndjeshëm infektimet e sëmundjet në bimët.</p>	<p>Gjithë bashkitë.</p> <p>Gjithë bashkitë, më pak Skrapari, Prrenjasi, Gramshi</p> <p>Gjithë bashkitë prej mungesës së specialistëve.</p> <p>Veçanërisht bashkitë Maliq, Gramsh.</p> <p>Bashkitë Pogradec, Skrapar, Prenjas. Gjithë bashkitë.</p> <p>Bashkia Pogradec, liq. i Ohrit.</p>

		Bashkia Pogradec, pyllëz. me pishë të zezë.
5.	Mjedisi social (urban/rural)	
	<p>a. Mungesa e menaxhimit të integruar të mbetjeve, i mangët në gjithë elementët e tij: mosreduktim i prodhimit të mbetjeve, mungesa e ripërdorimit të tyre për sa vlen, mosgrumbullimi i ndarë e më pas mos riciklimi i mbetjeve të riciklueshme, mungesa e kompostimit të të gjitha mbetjeve organike të biodegradueshme, mungesa e vend-depozitimeve të mbetjeve me standart të vend-depozitimit sanitar, janë makroproblemi aktual, burim i shumë pikave të ndotura të nxehta (hotspotet).</p> <p>b. Mungesa e trajtimit ose trajtimi jo i plotë i ujrave të përdorura, problem serioz edhe për shëndetin e popullsisë.</p> <p>c. Mostrajtimi (mospastrimi) i ujrave industriale.</p> <p>d. Mungesa e gjelbërimit rrugor dhe e sipërfaqeve të gjelbëruara, parqe, lulishte, partere të gjelbër, sipas normave standarte në qytetet, ndikon direkt në përkeqësimin e parametrave të ajrit, ul nivelin e rekreacionit, përkeqëson standartin e jetesës së komunitetit.</p> <p>a. Zhvillimet urbanistike pa plane të studiuar në gjithë gamën e faktorëve ndikues (krijimi apo devijimi i korridoreve të qarkullimit të ajrit në brendësi të qytetit, ngrohja me mënyra e sisteme të vjetëruar), shpërndarja e banorëve jo e studiuar. Etj), ulin cilësinë mjedisit urban.</p>	<p>Gjithë bashkitë përveç bashkisë Maliq.</p> <p>Gjithë bashkitë, Bashkia Pogradec rezulton më mire. Ka gjelbërim por jo mjaftueshëm në çdo bashki.</p> <p>Gjithë bashkitë, pavarësisht se aktualisht kanë PPV.</p>

Pikat e nxehta mjedisore (hotspotet)

Konsiderohen vendet ku grumbullohen materiale, mbetje, etj. që ndotin token, ujrave sipërfaqësore dhe ato nëntokësore, ajrin, me element toksikë që ato i përmbajnë. Në vijim jepen këto pika të nxehta për secilën nga 6 bashkitë që janë në zonën e studimit.

- Bashkia Skrapar
 - Zjarret në pyje dhe kullota
 - Permbytjet (kryesisht përgjatë lumit Osum, pranë qytetit Çorovodë)
 - Reshqitjet e dheut.
- Bashkia Maliq
 - Zjarret në pyje dhe kullota
 - Përmytjet (kryesisht në fushën e Maliqit Nj. A. Vreshtas)
 - Rëhqitjet e dheut (Bickë, Gjyrez)
 - Brejtësit (kryesisht në segmentin fshat Maliq – Lozhan, anës lumit Devoll).
- Bashkia Gramsh
 - Vend-depozitimi i mbetjeve, si rrezik ndotjeje në vazhdimësi i tokës, ajrit ujit nëntokësor e atyre sipërfaqësorë.
 - Mbetjet minerare.
- Bashkia Pogradec
 - Dampa e mineralit të hekur-nikelit në breg të liqenit, në Gurin e Kuq.

- Dampa e mbetjeve pas pasurimit të mineralit mbi fshatin Hudënisht.
- Galeritë e vjetra dhe materialet sterile pranë tyre.
- Vend-depozitimi i mbetjeve familjare të qytetit Pogradec.
- Bashkia Prrenjas
 - Vend-depozitimi i mbetjeve.
 - Ndotjet në lumen Devoll.
 - Mbetjet minerare dhe ato që rjedhin prej pasurimit të mineralit.
- Bashkia Librazhd
 - Vend-depozitimi i mbetjeve
 - Ndotjet në lumen Shkumbin

4. Prezantimi i NBS (Nature Based Solutions), si një mjet planifikues për minimizimin e impakteve negative prej ndryshimeve klimatike dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Sikundër u përmend në kapitullin e parë të këtij dokumenti, Zgjidhjet e Bazuar tek Natyra, janë një mekanizëm që sot ofrohet për minimizimin ose eliminimin e pasojave negative të një sërë dukurish të pazakonta. Këtu po përqëndrohemi në njërin prej tyre, dukurinë e ndryshimeve klimatike. Ndryshimet klimatike përfaqësojnë kërcënimin më të madh jo-ushtarak me të cilin është përballur ndonjëherë njerëzimi. Ky kërcënim ka aftësinë që të vërë në pikëpyetje të gjithë sistemet natyrore dhe shoqërore mbi të cilat bazohet ekzistenca e njeriut si specie natyrore dhe si qenie shoqërore. Në zonën e studimit, ndryshimet klimatike vënë në rrezik qëndrueshmërinë ekonomike të komuniteteve lokale, për shkak të uljes së disponueshmërisë së ujit, ekstremizimit të klimës, ndryshimeve në ciklin hidrologjik të ujërave, ndryshimit të mbulesës bimore, rënies së rendimenteve në blegtori dhe në kulturat bujqësore. Konkretisht, rritja e shpeshtësisë dhe ashpërsisë së rasteve të thatësirave, vë në rrezik furnizimin me ujë të fermave bujqësore. Po ashtu, rritja e shpeshtësisë dhe ashpërsisë së përmbajtjeve vë në rrezik jetën dhe pasurinë e komuniteteve të gjithë zonës. Sipas raporteve të OKB-së, rritja e temperaturave mesatare do të afrojë kohën e të korrave dhe të vjeljes, duke ulur cilësinë e produkteve, ndërsa shpeshtimi i valëve të të ftohtit do të rrezikojë mbarëvajtjen e kulturave bujqësore. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ka në fuqi dy strategji për ndryshimet klimatike: zbutjen dhe përshtatjen. Për “zbutjen” e ndryshimeve klimatike, në vitin 2015 OKB ka aktivizuar Marrëveshjen e Parisit e cila synon mbajtjen e ngritjes së temperaturës mesatare globale në jo më shumë se 2°C në krahasim me periudhën para-industriale, ndërkohë që deri tani temperaturat janë rritur tashmë me 1,2°C.

Paralelisht, OKB ka sugjeruar fort edhe strategjinë e “përshtatjes” me ndryshimet klimatike, që synon ndryshimin e sistemeve sociale e ekonomike njerëzore, duke i bërë ato sa më elastike ndaj impakteve nga ndryshimet klimatike dhe duke u dëmtuar sa më pak.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshjen e Parisit, më 22 prill 2016 në Nju Jork. Në vijim, Shqipëria ka dorëzuar pranë OKB-së dokumentin e Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar (KKP) me angazhime që reduktojnë emetimet e gazrave me efekt serrë deri në vitin 2030 me 11,5% në krahasim me vitin 2011. Në zbatim të këtyre angazhimeve, Shqipëria ka hartuar “Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike & Plani i Veprimit” (SKNK&PV) si dokumentin kryesor strategjik që synon fuqizimin e koordinimit mes sektorëve lidhur me masat e zbutjes dhe përshtatjes me ndryshimet klimatike, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

SKNK&PV u hartua në 2018 dhe u aprovua në 2019 në përputhje dhe në mbështetje të legjislacionit të atëhershëm të BE-së, por Komisioni i ri Evropian, nëpërmjet aprovimit të “Marrëveshjes së Gjelbër” (Green Deal) në 11 dhjetor 2019, i ngriti në një nivel cilësisht të ri ambiciet evropiane për mjedisin dhe klimën. Green Deal synon që deri në vitin 2050 Evropa të bëhet kontinenti i parë neutral ndaj klimës, pra

me emetime net zero të karbonit. Në 6 tetor 2021, BE transpozoi në Samitin “Bashkimi Evropian & Ballkani Perëndimor” në Sofie “Marrëveshjen e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor”, që përfaqëson po ashtu një shkallë të re të angazhimit kombëtar edhe për Shqipërinë. Baza ligjore e veprimit në këtë kuadër në Republikën e Shqipërisë është Ligji nr. 155, datë 7.12.2020 “Për ndryshimet klimatike”, i ndryshuar.

Paraqitje e ndryshimeve kryesore klimatike dhe e fenomeneve që lidhen me to e që rjedhin prej tyre, kryesisht në rajonin tonë

Ndryshimet kryesore klimatike

Ndryshimet klimatike kanë pasoja komplekse. Nuk bëhet fjalë vetëm për ngritje të temperaturës mesatare globale, por edhe për gjithë zinxhirin e pasojave natyrore dhe sociale e ekonomike të lidhura me të. Deri tani, Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC), i cili është autoriteti i vetëm shkencor për ndryshimet klimatike në botë, dhe me prestigj të padiskutueshëm, ka botuar gjashtë Raporte zyrtare mbi ndryshimet klimatike në planet. Më i fundit prej tyre, Raporti “AR6” i, është bërë publik në vitin 2022 dhe në fillim të vitit 2023. Ky raport është burimi i vetëm i besueshëm i të dhënave mbi ndryshimet klimatike. Të dhënat e këtij raporti janë specifikisht edhe për kategorinë “ekosistemet tokësore të zonës Mesdhetare”, ku përfshihet dhe zona në studim. Sipas këtij raporti, në zonën e e projektit evidentohen disa pasoja të lidhura me ndryshimet klimatike, si përshembull pasojat në ndryshimin e strukturës së ekosistemeve, në zhvendosjen e specieve drejt veriut apo drejt lartësive, dhe në ndryshimin e fazave fenologjike. Raporti thekson se me ndryshimet klimatike, në zonat e sipërcituara ka ndikime negative në sistemet humane, vecanërisht në rënien e aftësive për prodhime bujqësore për shkak të *i) kufizimit të sasisë së ujit; ii) rënies së shëndetit dhe produktivitetit të bagëtive; iii) uljes së produktivitetit të burimeve të peshkimit apo akuakulturës*, etj. Një rënie e produktivitetit ekonomik të lidhur me blegtorinë dhe bujqësinë, do ta shtynte komunitetin në zonën e projektit ose drejt emigrimit ose drejt shtimit të impaktit mbi burimet natyrore të zonës, çka do të përbënte kërcënim afatgjatë për cilësinë e ekosistemeve natyrore të zonës. Kjo e bën emergjent evidentimin dhe aktivizimin e një plani veprimi për përshtatjen me ndryshimet klimatike për aktivitetet ekonomike të komuniteteve.

Pasoja e fenomeneve që shfaqen prej ndryshimeve klimatike

1. Qytetet, qendrat e banuara, ekspozohen ndaj të nxehtit të pazakonshëm duke rrezikuar shëndetin e njerëzve.
2. Bujqësia ekspozohet ndaj humbjeve të konsiderueshme të prodhimit për shkak të thatësirave të zgjatura.
3. Rritet rreziku i zjarreve në pyje që shoqërohet me hallka të shumta në zinxhirin shkak-pasojë
4. Në pyje shfaqen dukuri të reja negative si shfaqja e bimëve të huaja invazive dhe uzurpimi prej tyre i sipërfaqeve pyjore, shfaqja e shtuar e dëmtuesve insekte, kërpudha, baktere, viruse, shfaqet gjithmonë e më dendur dritësimi i kursorave të drurëve që në shumë prej tyre arrin deri në tharjen e plotë të tyre.
5. Biodiversiteti kërcënohet, shumë lloje rrezikohen të zhduken, madje shumë prej tyre zhduken, futen lloje të huaj që prishin ekuilibret biologjikë.
6. Shtohen si sasi dhe shpeshtohen përmytjet.
7. Shtohen si sasi dhe shpeshtohen fenomenet e erozionit sipërfaqësor, reshqitjet e masiveve të tokës, orteqet e gurëve dhe të dëborës.

8. Pakësohen rezervat e ujit nëntokësor (i zgjatur në kohë ky fenomen shkakton krizën humane të mungesës së ujit të pijshëm) prej reshieve të vrullshme që favorizojnë rjedhjen sipërfaqësore të ujit dhe prej sasisë vjetore më të pakët të reshieve.
9. Zvogëlohet energjia elektrike e prodhuar nga burimet hidrike

Aktivite e masa që minimizojnë ose eliminojnë dukuritë negative që rjedhin prej ndryshimeve klimatike, nëpërmjet aplikimit të NBS (ZBN).

Fillimisht theksojmë se të zhvillosh aktivite apo të ndërmarrësh masa sipas NBS (ZBN), në thelb do të thotë të studiosh thellë natyrën, të kuptosh si mbrohet e përshtatet ajo ndaj fenomeneve negative dhe të tentosh të imitosh atë dhe jo t'i kundërvihesh me masa të ashpra ndërtimore, hidroteknike, etj. Vetëm një ilustrim: pas shumë ndërhyrjesh në një kohë të gjatë për sistemimin e shtretërve të lumenjve për të "disiplinuar" regjimin hidrik të tyre dhe eliminuar përmbytjet, erozionin, etj., sot po ndodh 'rinatyrimi' i tyre, si mënyra më e suksesshme e qëndrueshmërisë afatgjatë të tyre. Gjithashtu, çdo nismë, tashmë në zhvillim, për mbrojtjen e klimës, për frenimin e mbingrohjes globale, për luftimin e efektit 'Serrë' prej emetimit të gazrave që e shkaktojnë atë, apo zvogëlimin e humbjeve dhe rritjen e efijencës së energjisë, ndikon pozitivisht në përbalimin me sukses të ndryshimeve klimatike, pasi lufton faktorët që i shkaktojnë këto ndryshime. Me këtë mënyrë arsyetimi sugjerohet si vijon masa, aktivite që tentojnë të zgjidhin shqetësimet e paraqitura më sipër.

1. Në qendrat urbane zhvillimet urbanistike bëhen më të studiuara, termoizolimi i godinave përbën standart teknik të detyrueshëm, ujrat e reshieve grumbullohen e përdoren në mënyrë të dobishme (sanitare), shtohet gjelbërimi, kultivohen bimë dekorative drunore që u përshtaten më mire kushteve të reja klimatike, etj.
2. Bujqësia vuan thatësisht e zgjatura dhe kjo do të kërkojë përshtatje. Disa masa efektive do të ishin: dhënia prioritet kultivimit të bimëve me kërkesa më të pakta për ujë, përmirësime të rjeteve e sistemeve ujitës, ujitje me sasinë e nevojshme të ujit jo me përmbytje. Një masë shumë efikase është prodhimi i kompostit prej mbetjeve të shumta organike të biodegradueshme që bujqësia dhe ekonomitë shtëpiake prodhojnë, dhe aplikimi i kompostit në tokën bujqësore. Komposti përmirëson strukturën e tokës dhe mbi të gjitha, rrit kapacitetin ujëmbajtës të saj, gjë që ndihmon në përbalimin më mire të stresit të thatësisë prej bimëve. Nga ana tjetër, reduktohet në një masë të konsiderueshme sasia e përgjithshme e mbetjeve duke siguruar menaxhim efijent dhe të integruar të mbetjeve.
3. Zjarret në pyje, në mbi 95% të tyre shkaktohen prej njeriut. Me ndryshimet klimatike, rritjen e temperaturës dhe thatësisë e tejzgjatur, zjarri pasi shkaktohet merr përmasa të mëdha. Rritja e ndërjegjësimit, sidomos e grupeve e individëve që frekuentojnë pyjet (kryesisht barinjët, punonjësit e shfrytëzimit të pyjeve, grumbulluesit e bimëve medicinale, gjuetarët, vizitorët) lidhur me kujdesin që duhet të kenë duke parandaluar zjarret, ka rëndësi të dorës së parë. Një masë silvoteknike me rëndësi, që duhet të konsiderohet në strategjinë kombëtare të pyjeve është orientimi i pyjeve ekzistues drejt pyjeve të përzier (struktura më e mire 60 – 65% bimë drunore fletore dhe 35 – 40% bimë drunore halore). Po kjo strukturë duhet zbatuar në formulat e pyllëzimeve të reja. Pas zjarreve në pyje, duhet ndaluar kullotja dhe sipërfaqet e djegura të lihen të rigjenerohen, ku fillimisht instalohen natyrisht bimët drunore e shkurreore pioniere, e më pas llojet kryesore. Kështu, duke imituar natyrën, me këta lloje duhet të ndërhyjë me mbjellje edhe

njeriu në pjesët e djegura ku nuk instalohet natyralisht bimësia. Kështu realizohen: qëndrueshmëria e biodiversitetit, rikthehen në një kohë relativisht të shkurtër gjitarët dhe pjesa tjetër e faunës, mikroflora dhe mikrofauna e dëmtuar e tokës riinstalohet dhe fillon aktivitetin e vet të transformimit të lëndës bimore të vdekur në elementet ushqyes mineralë.

4. Problematike edhe në zonën e studimit është shfaqja e bimëve invazive si Arra e Hindit, e insekteve të ndryshëm dëmtues të drurëve pyjorë. Për Arrën e Hindit, në fazën fillestare, kur shfaqen individët e parë, bëhet asgjësimi i tyre me shkulje dhe kjo ndodh tre vite resht. Ka mundësi të madhe suksesi. Për insektet e dëmtuesit e tjerë, prioritet duhet të ketë forma biologjike e luftimit. Psh., për Proçesionaren e Pishës (Theumatopea), tradita e luftimit të saj ka qënë ajo mekanike. Sot përvoja e botës ofron metoda të tjera, konkretisht janë në zhvillim disa prej tyre si: luftimi prej një insekti tjetër insektngrënës, brumbullit Calossoma dhe, luftimi duke ofruar si ushqim koncentrat të frutave të bimes drunore, tespie (Melia azederah). Po ashtu zhvillimet e fundit në Zvicër tregojnë për shfaqjen e një insekti (Tigermücke – Aedes albopictus) që vjen nga Azia dhe është mbartës i virusit që shkakton sëmundjen e etheve të verdha. Ky insekt i rrezikshëm po tentohet të luftohet nëpërmjet hedhjes në terrenet e infektuar, të meshkujve sterile të këtij lloji insekti.
5. Në radhë të parë, duhet rritur shumë kujdesi për bimët dhe speciet e tjera të rrezikuara, sipas klasifikimit që ka bërë IUCN në librin e kuq (të kultivohet kjo si një praktikë dhe edukate pune prej punonjësve të pyjeve dhe atyre të zonave të mbrojtura, më tej edhe prej specialistëve të bujqësisë). Masat e sugjeruara në pikat më lart, 3 dhe 4, vlejné plotësisht.
6. Masë me rëndësi kryesore në gjithë territorin e vendit tonë, pra edhe në zonën e studimit, është ripyllëzimi i gjithë sipërfaqeve të çveshura të pellgjeve ujëmbledhës të lumenjve (në rastin tonë të lumit Shkumbin dhe të lumit Osum, në pjesën e sipërme të tyre), të shoqëruara me masa mbrojtëse sistemuese biologjike dhe me material vendi si gjerdhe çift antierodive, mbjellje bimësh shkurre që lidhin fort token (si hipofaja e të ngjashme). Masë tjetër (zbatim korrekt i NBS) është rinatyrimi i lumenjve në gjithë rjedhën e tyre duke e kthyer ujin në shtratin e vet të vjetër natyral. Xhepat e krijuar në vite, të trajtohen me kujdes si habitate të lagësht (instalim i vërriut, plepave, shelgjeve, kallamave), sepse këta shërbejnë si depozita natyrale rezervë të ujit të lumit kur ky ka prurje maksimale. Natyrisht, duhet të ndalohen ndërhyrjet në shtratin e lumit për marrje rëre e zhavorri, pa studime dhe pa përcaktime të sasisve atje ku mud të merren.
7. Në shumicën e tyre këta fenomene ndodhin në terrenet malore. Kur faqet e tyre janë të veshur me pyll këta fenomene minimizojnë efektet e tyre. Në terrene të çveshur shkëmborë, aplikohen gjerdhe, mure mbrojtës antiorteqesh (struktura me kollona dhe rjeta teli), etj. Çdo masë kundër përmbytjeve ndikon pozitivisht edhe për mbrojtjen prej këtyre fenomeneve.
8. Përdorimi me efikasitet të ujit të pijshëm, grumbullimi dhe përdorimi i ujit të reshieve për qëllim sanitar. Pylli ushqen ujrat nëntokësore me ujë të pastër, me standartet e ujit të pijshëm. Ai kontigjent i ujit të reshieve që bie mbi pyll depozitohet në token e pyllit dhe filtrohet ngadalë prej tre filtrave gjigandë, tokës pyjore, shkëmbit amnor, sistemit rrënjor të bimëve (filtri mekanik, kimik, biologjik). Toka e pyllit ka kapacitet ujëmbajtës der 10 herë më të lartë se toka bujqësore. Pra edhe përballon sasi shumë më të madhe reshiesh pa krijuar rjedhje sipërfaqësore vija, rrëke, proska, përrenj, lumenj, që mbyllin ciklin me derdhjen në det dhe, që nuk përfundojnë në ujin nëntokësor (por që toka pyjore i kalon në ujin nëntokësor).
9. Ndërgjegjësim për domosdoshmërinë e diversifikimit të burimeve e formave të prodhimit të energjisë.

Bibliografi

I – Literatura

1. Zeitschrift 'die umwelt' (revistë periodike tremujore, numri 2/2023)
Focus: 'KLIMAWANDEL – WIE GEHEN WIR DAMIT UM?'
2. 'Biodiversität im Wald', strategisches Programm der schweizerischen Regierung.
3. 'Waldwirkung auf Hochwasser', Christoph Hegg
4. 'Hochwasser ist ein natuerliches Phaenomen - Hochwasserschaeden nicht', Martin Kennel, Gjermani
5. 'Die Buche – eine Baumart des Objektschutzwaldes' Frank Perzl, Austri
6. Management Plan Tomorri (draft)
7. Suplementi i PM. Ohrit
8. Planet vendore bashkiake

II – Burimet e sigurimit të informacionit

1. Specialistë të sektorit të pyjeve në bashkitë Skrapar, Gramsh, Librazhd, Prenjas, Maliq, Pogradec.
2. Specialistë dhe drejtues të AdZM-ve Elbasan dhe Berat.
3. Vrojtime vetiake në zonat e mbrojtura të bashkive Maliq, Pogradec, Librazhd, Prenjas.